




REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË • OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilafuar Më Datë 20.07.2022

Nr. i organit	Kumari/Dr. i	Shtetësi	Vlera
Org. broj	Prilog	Prilog	Vrednuesi

01-060/01-757



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -VII- të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **29.07.2022 (e Premte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e rregullt e KK-së.
2. Informatë (Raport) i kryetarit të komunës për periudhën Janar-Qershor 2022.
3. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar - Qershor 2022.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtjen e Mjedisit për vitin 2022.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës se Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2023.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendim, me numër të Protokollit 01-110/05-216 të datës 04.03.2019.
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik.
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për vizitë në Shqipëri, shkëmbim provojave dhe thellim i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel lokal në mes të dy komunave, Bashkia e Tiranës njësisë Administrative Krrabë dhe komuna e Vitisë

Viti, më 20.07.2022

Me respekt!
Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
Pranuar / Prihvata / Accepted: 20.07.2022, Vitina			
Nr./Q/8888 Org. broj	Numri/Broj	Shtetëse Pollog	Vlera Vrednosit
02-052 / 02-755			

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

***Informatë (Raport) e punës së Kryetarit të Komunës për periudhën
Janar – Qershor 2022***

PËRMBAJTJA

- Përmbajtje	2
--------------------	---

KAPITULLI I

- Hyrje	3
- Përmbledhje ekzekutive	3

KAPITULLI II

Raportet e Zyrave të Kryetarit

- Njësia e Auditimit të Brendshëm	4
- Njësia e Personelit	4
- Zyra për Barazi Gjinore	5
- Zyra e Prokurimit	5
- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun	6
- Lektori	6
- Zyra Ligjore	6
- Zyra e Avokatit Publik të Komunës	7
- Zyra për Integritet Evropian	7
- Zyra për Projekte	7

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

- Drejtoria për Administratë	8
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	12
- Drejtoria për Inspeksion	15
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	17
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	21
- Drejtoria për Arsime	33
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	36
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	37
- Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi	40
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	42

Hyrje

Përmbledhje ekzekutive

Komuna si njësi themelore e pushtetit lokal, funksionon në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/08), Statutit të Komunës si akti më i lartë i Komunës si dhe Ligjeve të tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fushëveprimi i saj.

Qeverisja e mirë në komunën tonë ka qenë dhe do të jetë ndër objektivat tona kryesore dhe në përputhje me planin tonë strategjik, me të cilin plan synojmë të kontribuojmë në përmirësimin e shërbimeve komunale. Modalitetet e qeverisjes sonë gjatë kësaj kohe për të cilën raportojmë janë karakterizuar me ngritjen e performances në të gjithë sektorët, cilësinë e shërbimeve, si dhe transparencën komunale.

Politikat publike të komunës dhe harta e investimeve komunale janë treguesit më të mirë se, Komuna e Vitisë ka shënuar rritje të besimit politik te qytetarët, te grupet e organizuara me interes, siç janë: bizneset, OJQ-të dhe shoqëria civile në përgjithësi.

Janë rritur parametrat e vlerësimit të punës, është rritur cilësia e punimeve në infrastrukturë si: rrugë, kanalizim, ujësjellës, mbrojtje të mjedisit, e të tjera.

Sa i përket funksionimit të shërbimit civil të Administratës Komunale të Vitisë, shërbimi civil është i paanshëm dhe i përgjegjshëm, ku këtë e dëshmon më së miri klima antidiskriminuese që është krijuar në Administratë, në të cilën çdo shërbyesi civil i është krijuar hapësirë e nevojshme veprimi për ti shprehur mendimet e veta profesionale, gjë që ka rezultuar edhe me ngritjen e efikasitetit të punës në administratën komunale.

Raporti prezent, pasqyron përmbledhjen e punës për periudhën janar – qershor 2022 të të gjitha organeve komunale, duke përfshirë Njësitë, zyret e Kryetarit si dhe drejtoritë komunale me sektorët e tyre, me prioritetet si në vijim:

- Rritja e efikasitetit në Administratë;
- Zhvillimi i bujqësisë;
- Shëndetësia, arsimi, kultura dhe sporti;
- Infrastruktura lokale;
- Shërbimet publike;
- Zhvillimi ekonomik;
- Përkujdesja për shtresat e varfra dhe grupet e marginalizuara;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët;
- Mbrojtja e ambientit dhe kualiteti i jetës.

Raportet e Zyrave të Kryetarit

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB)

Sipas Planit vjetor të NJAB-së, për vitin 2022 janë të planifikuara të kryhen 4 auditime. Dy auditime në gjashtëmujorin e parë dhe dy në gjashtëmujorin e dytë.
Për periudhën Janar – Qershor, kemi kryer vetëm një auditim:

1.1 Emërtimi i auditimit:

Auditimi Nr.DSHS-22/01

Tema e auditimit: Zbatimi i procedurave të prokurimit publik për furnizime me mallra, shërbime dhe punë për periudhën e vitit 2021

Njësia e Burimeve Njerëzore

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2022, Njësia e Burimeve Njerëzore ka kryer punët në bazë të kompetencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji për Zyrtaret Publik, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin e Punës, Ligjin mbi Pagat, Ligjin mbi Administratën Shtetërore, si dhe aktet tjera nën ligjore, Statuti i Komunës dhe Vendimi mbi organizimin e organeve komunale dhe aktet tjera nën ligjore të cilat rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës.

Njësia e Burimeve Njerëzore për vitin 2022, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës ka hartuar planin e Personelit në bazë të udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Ministria e Administratës Publike, Departamenti i Shërbimit Civil si dhe Drejtoritë përkatëse në veçanti me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Njësia e Burimeve Njerëzore ka zhvilluar të gjitha procedurat për pozitat: lëvizje paralele dhe pranim dhe për zyrtaret publik të cilat i ka pasur në plan të personelit për pjesën e parë të vitit 2022.

Pozitat të cilat i kemi rekrutuar përgjatë periudhës raportuese sipas kërkesave të drejtorive dhe planit të Personelit janë: 17, ku për disa pozita është bërë lëvizje e brendshme e stafit, ndërsa për disa të tjera janë zhvilluar procedurat e konkursit publik. Janë lëshuar 3 vendime për pensionimin e punëtorëve. Janë lëshuar 3 vendime për një pagë përcjellëse pas pensionimit.

Zyra për Barazi Gjinore

Në raport janë prezantuar aktivitetet të cilat pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara përgjatë periudhës janar – qershor 2022, ku prej tyre veçojmë:

- Takime dhe tryeza me shoqërinë civile, OJQ-të, komunitetin e të rinjve për implementimin e ligjeve të aplikueshme në funksion të të barazisë gjinore (2 takime);
- Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjes “Njih të Drejtat” – prezantimi i të drejtave për trashëgiminë dhe pronën, konform ligjeve në fuqi, gjegjësisht LTK-së;
- Analiza gjinore dhe përgatitja e buxhetimit gjinor në kategoritë ekonomike: paga mëditje, subvencione dhe investime kapitale;
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera:
 - zhvillim ekonomik;
 - punësim / mirëqenie sociale;
 - shëndetësi;
 - procesin e vendimmartjes.
- Dhënia e rekomandimeve në fushën e barazisë gjinore për Strategjinë për Zhvillim Ekonomik, e cila është në proces të diskutimit publik;
- Organizimi dhe mbajtja e ligjëratave për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, kundër dhunës në familje dhe keqpërdorimi i rrjeteve sociale;
- Trajnim për fuqizimin e rolit të Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje dhe praktikat më të mira nga Konventa e Stambollit;
- Fuqizimi ekonomik i grave (bizneseve për vetëpunësim) përmes ndarjes së garantëve për zhvillimin e bizneseve (biznese për përpunimin e ushqimit), në partneritet me IADK, IKC, Caritas Zvicerran;

- Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit për të pranuar ankesat e qytetarëve të Komunës së Vitisë për shkelje të të drejtave të njeriut nga institucionet;
- Si dhe aktivitete tjera kontinuele.

Zyra e Prokurimit

Me këtë raport do të paraqesim të përmbledhur aktivitetet e prokurimit të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve gjegjësisht investimeve kapitale dhe furnizimeve me gjëra të ndryshme, bazuar në kërkesat dhe nevojat e AK që janë domosdoshmëri për plotësimin e aktiviteteve të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotësimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtje pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara sipas buxhetit të këtij viti e që është në interes të komunitetit dhe rritjen mirëqenies qytetare në përgjithësi. Punët dhe aktivitetet Zyra e Prokurimit i zhvillon, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik.

Bazuar në këtë, Zyra e Prokurimit ka përgatitur këtë raport 6 muajor për kryetarin e komunës, duke përmbledh të gjitha aktivitetet e prokurimit 6 muajor për vitin 2022, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit dhe aktivitetet tjera të cilat janë në procedurë e sipër.

Në gjysmën e parë të vitit 2022, duke u bazuar në kërkesat e njësive shpenzuese dhe planifikimit të prokurimit për këtë vit, zyra e prokurimit ka inicuar 43 aktivitete të prokurimit.

Nga këto aktivitete, 21 janë përmbyll si aktivitete, tjerat janë në procedurë. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon: 27 raste është përdorë procedura e hapur, 15 raste procedura e kuotimi i çmimit dhe 1 aktivitate procedurë me Vlera minimale.

Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara: 21 aktivitete të prokurimit, janë përmbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave. Ndërsa; 22 aktivitete të prokurimit janë në zhvillim apo procedim të mëtutjeshëm. Dy aktivitete janë anuluar.

Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është 1,509.449.21 €.

Zyra e Prokurimit gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar 481 Urdhërblertje për dorëzim në Drejtorinë e Financave për procedim të pagesave të OE të kontraktuar, duke udhëhequr lëndet për kompletim. Zyra e Prokurimit ka kryer edhe 78 rekomandime për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlerësim dhe komisioneve tjera.

Zyra e Prokurimit në gjashtë muajorin e parë ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarëvajtjes së punëve në komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë kësaj periudhe ka publikuar dokumente mbi procedurat e konkurrimit dhe pranimin në punë;
- Janë publikuar gjithashtu Njoftime publike, Vendime të Kuvendit Komunal, Vendime të Kryetarit të Komunës, të gjitha draft dokumentet të cilat janë paraparë të shqyrtohen në Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal;
- Kemi harmonizuar dhe funksionalizuar uebfaqën në gjuhën serbe;
- Po ashtu janë publikuar edhe disa Plane e Raporte si dhe Dokumentet të cilët ndërlidhën me shpenzimin e parasë publike;
- Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë, kemi pasur me mediat lokale dhe ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga komuna e Vitisë edhe përmes fotografive;
- Zyra për Informim publik ka përcjell të gjitha aktivitetet e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në terren;
- Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaj në komunën tonë;
- Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: Shpallje, Konkurse, tenderë, Njoftime etj;

- Zyra për Informim ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet, punëtorit dhe mbledhjet e ndryshme për ndryshimin e pakos ligjore për Transparencë dhe finalizuar ndryshimin e Rregullores për Transparencë. Kurse gjatë vitit 2022 (në pjesën e dytë të vitit) pritet të bëhet edhe hartimi i Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 4 vjeçare.

Lektori

Gjatë periudhës kohore Janar - Qershor 2022, si lektor Administratës së Komunës dhe i Kuvendit të Komunës së Vitisë kam kryer punë dhe detyra të punës sipas përgjegjësisë zyrtare dhe përshtimit të detyrave të vendit të punës. Kam lekturuar dokumente zyrtare për Zyrën e Kryetarit, për Kuvendin e Komunës, për drejtorinë, për njësitë dhe zyrat komunale etj.

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2022 kam lekturuar këto dokumente:

1. Informata vjetore e Kryetarit të Komunës me drejtorin komunal 2021. Kërkesë dy ministrive (27.06.2022), Konkurs 2022-2023 (27.06.2022), Kërkesë për qarkore ligjore (24.01.2022), Konkursi për nxënës 2022, Konkursi për çerdhen e fëmijëve “Gëzimi Ynë” 2022, Propozim Vendim (29.04.2022), raporti Janar-qershor 2022 i DKA-së, Aktvendim mbi uzurpimin e tokës (17.03.2022), Kërkesë (07, 09, 24. 03.2022), Informatë nga manifestimi “Flakadani i Karadakut”, Vendim (24.03.2022), Debat publik, KPF (10.06.2022), Vendimet 23.03.2022 (8 vendime), Vendimet 15.02.2022 (9 vendime), Vendimet 20.06.2022 (9 vendime), Vendimet 25.05.2022 (8 vendime), Vendimet 27.01.2022 (8 vendime), Vendimet 27.04.2022 (8 vendime), Plotësim ndryshimi i statutit 16.05.2022, Fakturë 07.03.2022. Vendime 22.06.2022 (3 vendime), Vendime 3.2.2022 (1 vendim), Vendime 19.05.2022 (1 vendim), Vendime 28.02.2022 (1 vendim). Shkresë ministrisë për interpretim ligjor 02.06.2022, Letër OSB-së 23.02.2022, mirënjohje LPK-së 15.06.2022.
2. Procesverbalet e Kuvendit Komunal (I, II, III, IV, V), ftesa për KK (i, II, seanca solemne), Kërkesë 14.01.2022 (2 kërkesa).
3. Procesverbalet e KPF-së (I, II, III, IV, V).
4. Procesverbalet e KKS-së (I, II). Ftesat në KPF (I, III, V).

Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkesë me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë (Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal).

Zyra Ligjore

Bazuar në dispozitat ligjore neni 74 pika d të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, lidhur me dispozitat ligjore neni 46 të vendimit të Kryetarit të Komunës për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës Komunale, Zyra Ligjore në kuadër të ushtrimit dhe përgjegjësisë, autorizimeve si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve me fuqi nën-ligjore, gjatë vitit 2020/21 ka bërë një punë cilësore duke kryer harmonizimin dhe korrigjimin e akteve nënligjore të propozuara nga Kryetari i Komunës dhe nga drejtorët e drejtorive si dhe hartimin e rregulloreve që janë në kompetencë të Komunës sipas ligjit mbi vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040.

Zyra Ligjore për periudhën janar – qershor 2022, kryer këto punë: Propozim vendime 58, Vendime 105, Marrëveshje Bashkëpunimi 8, Përgjigje në kërkesë 119, Interpretime ligjore 302.

Zyra e Avokatit Publik të Komunës

Për kohën për të cilën po raportojmë janar- qershor 2022, janë kryer këto punë:

Lëndët e regjistruara gjyqësore për vitin-kohen për të cilën tani që po raportojmë, të të gjithave procedurave gjyqësore janë **37 lëndë të regjistruara**, **23** lëndë janë lëndë nga procedura civile-në procedurë kontestimore të natyrave të ndryshme, **5** lëndë janë të procedurës jashtkontestimore, **9** lëndë janë të procedurës penale, për të cilat lëndë janë ushtruar kallëzime penale, të cilat sipas detyrës zyrtare i udhëheqë prokurori i shtetit, Prej lëndëve kontestimore në procedurën civile të cilat në numër janë **23**, ku avokati kundër këtyre lëndëve ka ushtruar **23** përgjigje në padi kundër paditësve. Ndërsa nga lëndët e bartura nga vitet paraprake, të cilat janë ende në procedurë, prej këtyre lëndëve të bartura për të cilat janë mbajtur shumë seanca gjyqësore me vite në

- këtë periudhë që tani po raportojmë janë përfunduar me aktvendim, aktgjykim, të formës së prerë nga Gjykata tona janë përfunduar 6 lëndë që kanë të bëjnë me bazë juridike për pagat pas pensionit dhe për pagat jubilarë, ndërsa 23 lëndët kontestimore civile të cekura më lartë për periudhën tani që po raportojmë, janar qershor për 2022. Këto lëndë janë të gjitha në procedurë gjyqësore, ndërsa 9 lëndë penale lidhur me uzurpimet në pronësinë shtetërore nga Neni 332, paragrafi 1 i KPRK, që sipas detyrës zyrtare i udhëheq prokurori i shtetit, janë në procedurë për shqyrtim gjyqësor. Ndërsa lëndë që i përkasin procedurës jashtëkontestimore të cilat fillojnë me propozim, që kanë të bëjnë me gjetjen e sinorëve dhe rregullimin e megjave tokësore të palujtshmërive, të cilat janë 5 dhe ende janë në procedurë gjyqësore. Sa i përket mjeteve të jashtëzakonshme juridike, të njëjtat nuk mund të paraqesin sepse nuk kemi aktgjykime të formës së prerë të Gjykatës së Apelit. Meqenëse nëpër gjykatat tona ka shumë lëndë të viteve paraprake, të cilët kërkojnë zgjidhje, ende nuk janë treguar edhe përkundër disa parashtresave të ushtruar nga avokoti i komunës për disa lëndë të cilat janë me prioritet, por ende nuk kemi ftesa për shqyrtim kryesor.

Zyra për Integritet Evropian

Zyra Komonale për Integritet Evropian, Zyrtari për integritet evropian gjatë periudhës janar – qershor 2022, ka kryer këto aktivitete:

Kemi profilizuar Planin Kombëtar për Integritet Evropian 2022 dhe i kemi ofruar rekomandime Zyrës së Kryetarit të Komunës, Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit, drejtorive komunale dhe zyrave ndihmëse të Kryetarit të Komunës, për plotësimin e objektivave që dalin nga Plani Kombëtar për Integritet Evropian 2022; Kemi mbajtur takim njoftues me Zyrën e Kryetarit të Komunës, Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit; Kemi marrë pjesë në takimin e Kolegjiumit të ZKI-ve, me AKK dhe MAPL-në; Kemi përcjell punimet e takimeve të KPF-së; Kemi përcjell punimet e seancave të Kuvendit të Komunës; Kemi marrë pjesë në komisionin për riintegrim, në bordin e drejtorëve; Takime me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për instrumentet financiare të BE-së, informata për TAEX.

Zyra për Projekte

Bazuar në detyrat e punës nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe kërkesat e zyrës së projekteve gjatë periudhës janar- qershor të vitit 2022, kemi punuar në hartimin e projekteve, raporteve të pranimi të tyre dhe mbikëqyrjes së zbatimit të projekteve.

Përveç hartimit të projekteve të lartpërmendura kemi kryer edhe këto punë si:

- hartimin e detyrave projektuese
- Pranimin teknik të hartimit të projekteve të ndryshme
- Pranime teknike të projekteve të përfunduara
- Komisione të ndryshme për vlerësim
- Menagjimi i zbatimit të projekteve
- Angazhime tjera shtesë sipas kërkesave të menaxhmentit.

Raportet e Drejtorive

Drejtoria për Administratë

Misioni i Drejtorisë për Administratë është zbatimi Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ligjeve tjera që aplikohen në Administratë, Udhëzimet Administrative të nivelit qendror, Statutit të Komunës së Vitisë dhe akteve tjera komunale të aprovuara nga Kuvendi i Komunës.

Drejtoria e Administratës, kryen shërbime të përgjithshme administrative për organet e administratës dhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Komunës së Vitisë.

Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera të kësaj drejtorie përfshijnë:

- Ofrimi i shërbimeve dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punën e Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit të Komunës dhe Këshillit të Drejtorëve;
 - Përgatitja e akteve të cilat i nxjerr Kryetari i Komunës, Këshilli i Drejtorëve;
 - Harton propozim rregullore, propozim vendime në fushën e Administratës;
 - Kujdeset për përkthimin e materialeve të Kuvendit, trupave të kuvendi dhe Këshillit të drejtorëve duke respektuar gjuhët zyrtare;
 - Drejtoria e Administratës ka realizuar objektivat të cilat dalin nga Plan i Punës së Drejtorisë për vitin 2022;
 - Drejtoria për Administratë ka hartua planin e veprimit për muajt Janar-Dhjetor 2022 për arsye të kryerjes së shërbimeve administrative për bashkatdhetarët që vijnë nga bota e jashtme për pushime verore.
- Në vazhdim do të paraqesim punën e sektorëve të kësaj drejtorie.

I. Sektori për punë administrative

Sektori për punë administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Kryetarit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve dhe drejtorit të Drejtorisë për Administratë.

Ky sektor ka përgatit ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Këshillit të Drejtorëve, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i Komunës ka mbajtur 6 seanca të rregullta, të jashtëzakonshme 0, solemne 4. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta. Komiteti për komunitete ka mbajtur 4 mbledhje dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta.

Kuvendi i Komunës ka miratuar: 0 rregullore dhe 1 plotësim-ndryshim të rregullores, dhe 49 vendime të ndryshme. Të gjitha këto akte normative të Kuvendit janë përgatit për procedurë për nënshkrim dhe protokollim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve. Janë përgatit 6 procesverbale të seancave të Kuvendit të Komunës, 5 procesverbale të Komitetit për Politikë dhe Financa, 4 procesverbale të Komitetit për Komunitete, dhe 3 procesverbale të KKS, 4 procesverbale të seancave solemne, 0 procesverbal i seancës së jashtëzakonshme..

Gjatë kësaj periudhe raportuese Këshilli i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje konsultative, ditore, javore dhe mbledhje të rregullta ku janë shqyrtuar materialet të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal. Për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve është përgatit materiali si dhe janë hartuar procesverbale për këto mbledhje.

Për nevojat e Kryetarit të komunës për këtë periudhë raportuese janë hartuar dokumente të ndryshme si vendime, marrëveshje të ndryshme, kërkesa dhe shkresa të ndryshme. Dokumentet e hartuara janë të natyrave të ndryshme: Propozim vendime për kuvend, të ndarjes së ndihmave financiare, vendime për formimin e komisioneve të ndryshme për pranimin e mallit, vendime për caktimin e menaxherit për mbikëqyrjen e punëve, vendime për pranimin teknik të punëve etj.

Zyrtari për përkthim ka përkthyer në mënyrë simulantë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit për Siguri në Bashkësi, Komitetit për Komunitete dhe Këshillin e Drejtorëve. Gjithashtu ka përkthyer edhe të gjitha materialet të cilat kanë dal nga mbledhjet e Kuvendit, KPF, KKS, Komitetit për Komunitete dhe Këshilli i Drejtorëve.

II. Sektori i gjendjes civile

Në vazhdim po e paraqesim numrin e dokumenteve të lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën Janar – Qershor 2022,

Nr.	Përshkrimi i Lendeve	totali
1	Ekstrakt nga regjistri qendrori gjendjes civile	8096
2	Certifikata Lindjes	5259
3	Certifikata e martesës	2590
4	Certifikata e Vdekjes	879
5	Certifikata Vendbanimi	394
6	Deklaratë për bashkësinë familjare	2552
7	Certifikata e gjendjes martesore	609
8	Certifikata e Shtetësisë	120
9	Vërtetim nga Arkivi	317
10	Vendimet	70
11	Aktvdekjet	81
12	Vërtetimi Mjeteve	42
13	Vizita	10
14	Regjistrimet në LAL të jashtme	104
15	Regjistrimet në LAL të brendshme	2
16	Regjistrimet në LAV (vdekje të jashtme)	49
17	Regjistrimet në LAV (vdekje të brendshme)	60
18	Regjistrimet në LAM të jashtme	50
19	Kurorëzime të reja	223
20	Shkurorëzime	11
21	Humbje Shtetësie	3
22	Fitim Shtetësie	1
23	Çlajmrim i venbanimit	2
	Totali i dokumenteve të lëshuara	21531

Numri i përgjithshëm i dokumenteve të lëshuara për periudhën Janar – Qershor 2022 është 21483 dokumente. Qytetar të futur në sistemin e Gjendjes Civile janë: 56231

III. Sektori i Zyrës pritëse dhe arkivit

Zyra Pritëse, në kuadër të aktiviteteve të saj të cilat i ka kryer për këtë periudhë raportuese për periudhën Janar-Qershor 2022 janë si: regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtresave, shërbimet postare për organet e administratës komunale, ofrimin e ndihmës juridike qytetarëve për plotësimin e kërkesave, dhe regjistrimin e kërkesave në protokoll.

Numri i kërkesave të pranuar në zyrën pritëse është paraqitë në formë tabelore.

Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve -L.A.V nga jashtë	23
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Martuarve -L.A.M nga jashtë	39
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Lindurve -L.A.L nga jashtë	93
Kërkesa për regjistrim në LAV brenda vendit	60
Deklarata për vendqëndrim	0
Deklarata për trashëgimi	93
Deklarata për përkujdesje financiare	42
Deklaratë për regjistrimin të më vonshëm në LAL	0
Deklarata për regjistrim në LAV	32
Gjithsejtë:	382

LËNDËT E ARKIVUARA

Drejtoritë	Nr. i lëndëve të arkivuara
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	189
Drejtoria për Administratë	17.267
Drejtoria për Arsim	988
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	74
Drejtoria për Financa Ekonomi, dhe Zhvillim	4.264
Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport	188
Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit	64
Drejtoria e Inspeksionit	38
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	523
Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	2.558
Kuvendi i Komunës	7
Zyra e Kryetarit	44
Zyra për Komunitete	1
Totali	20.205

IV. Sektori i administrimit

Ky sektor përfshin shërbimet që kanë të bëjnë me mbështetjen logjistike të organeve të administratës dhe atë: Kujdesit për mirëmbajtjen e auto veturave zyrtare të organeve të administratës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Vërejtje: Për punë më efikase dhe menaxhim me te suksesshëm ne këtë sektor duhen te bëhet renovimi i objekteve komunale, autoparkut, dhe krijim i hapësirave të nevojshme për punë.

Në vazhdim po i prezantojmë shpenzimet e mirëmbajtjes, karburanteve dhe shpenzime tjera për automjete dhe gjeneratorë për periudhën Janar – Qershor 2022.

Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë për periudhën raportuese janë ; 13344.00euro.

- Administrata.....4755.00€,
- Shëndetësia 4052.00€ dhe
- Njësia e zjarrfikëseve..... 4537,00€

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, gjenerator, nxehje qendrore dhe autorizime për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë.

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë: 21342 litra

- Administrata.....7994 litra (Zyra e Kryetarit, DKA-ja dhe autorizimet);
- Shëndetësia7968 litra; dhe
- Njësia e zjarrfikës.....5380 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për nxemje qendrore për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë; 4025 litra naftë,

- Administrata..... 4025 litra
- D. Kulturës..... 0 litra
- Shëndetësia 0 litra,
- Njësia e zjarrfikësve.....0 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për gjenerator për të gjitha njësit shpenzuese janë: 645 litra.

- Administrata..... 36 litra,
- Shëndetësia..... 39 litra,
- Njësia e zjarrfikësve..... 80 litra.
- DKA-ja (Shkollat) 490 litra.

Zyra e IT-së ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllimin e zbatimit të standardeve dhe ofrimin e shërbimit më cilësor, në veçanti:

- Ka zbatua hardware, Softwerin Kompjuterik dhe të qasjes me internet
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet dhe kyçe sipas nevojave të ndryshme për organet komunale.

PËR PERIUDHËN janar-qershor 2022

Nr.	Emërtimi	Nr. Intervenimeve	Vërejtje
1	Risetimi i password të Domenit	95	
2	Hapja e Userve të Domenit	25	
3	Hapja e Userave të Intranetit	10	
4	Intervenimet në Usera	70	
5	Intervenimet në rrjetin qeveritar	72	
6	Intervenimet në programe	100	
7	Konfigurimi i sëiqit	0	
8	Intervenimet në Gjendjen Civile	75	
9	Intervenimet në Tatimin Pronë	40	
10	Futja e kompjuterëve në Domen	75	
11	Instalimi i software	00	
12	Instalimi i computerhardwaredevices	00	
13	Rregullimi kablllove të internetit	50	
14	Intervenimet në E-mail	60	
15	Hapja E-mail Zyrtar të reja për zyrtar Komunal	20	
16	Intervenimet në Intranet	100	
17	Monitorimi i Kuvendit përmes Teleprezencës	0	
18	Drejtoria Arsimit	20	
19	Qendra për punë sociale	40	
20	Telefonave VOIP	15	
21	Asistimi në rregullimin e fotoko.,printe etj	100	
22	Përkrahja në takime virtuale	30	
	Gj i t h s e j t ë	1147	
1. Mirëmbajtja e Serverit çdo ditë 2. Mirëmbajtja e Intranetit çdo ditë 3. Mirëmbajtja e Gjendjes Civile çdo ditë 4. Mirëmbajtja e-pasurisë çdo ditë 5. Sistemi për menaxhimin dhe arkivimin elektronik të dokumenteve çdo ditë 6. Menagjimi i disa kontratave 7. Trajnime të ndryshme virtuale dhe fizike			

Pranues i mallrave ka kryer këto detyra të punës:

-Pranimin dhe regjistrimin e mallrave në sistemin e menaxhimit të Pasurive (E-Pasuria),ku në të përfshihen materialet shpenzuese si dhe asetet Komunale ku vlera e këtyre materialeve është 21915.40 € apo mbi 40 lëndë;

-Janë bërë mbi 65 kërkesa për furnizime me material për zyre dhe inventar;

-Janë bërë furnizime me material shpenzues si dhe inventar për të gjithë njësit shpenzues të Komunës së Vitisë duke përfshirë zyrën e Kryetarit dhe të gjitha drejtorit tjera dhe Komunitetet;

Ka asistuar në disa para masa për furnizim me material shpenzues si dhe ka kryer detyra tjera që iu janë besuar nga menagjmenti i Komunës.

- Janë regjistru në SIMFK 737 kupona të shpenzimit me procedurë të prokurimit dhe të aprovimit në vlerë prej 1918520.73€;
- Janë bërë 4 kërkesa përmes SIMFK –së për para të gatshme në vlerë prej 1800.00€;
- Janë bërë pagesa me të gatshme në vlerë prej 917.38€;
- Janë pranuar 297 raporte nga drejtorit që inkasojnë të hyra vetanake dhe janë bërë 66 deponime në bankë në vlerë prej 67293.00€;
- Janë regjistru në analitik shpenzimet përmes transferit dhe dokumentacioni origjinal, është arhivu, numri lëndëve është 747 në vlerë prej 1918520.73€;
- Gjatë periudhës Janar – Qershor 2022, në programin e administratës komunale dhe arsimit parauniversitar janë dorëzuar në MAPL - divizioni i pagave (punëtor të ri, largime dhe ndryshime) 269 ndryshimet nga QKMF-ja, kopje të pranuar të cilat janë përfshirë në evidencën e përgjithshme të ndryshimeve, janë 232.
- Është mbajtur evidencë analitike e pagave sipas muajve, sipas programeve dhe kartel individuale e 1165 të punësuar në programin e arsimit, administratës, shëndetësisë dhe 27 këshilltarët e asamblesë komunale;
- Janë pranuar evidentu dhe protokolu 204 fatura, kontrata, vendime në vlerë prej 376198.63€ të vitit 2021 dhe janë procedu për zotim;
- Janë nxjerrë 927 kërkesa për zotim me modulën e blerjes dhe me modulën e aprovimit duke i përgatitur kërkesat për zotim sipas programeve buxhetore , kodit ekonomike dhe kodit projektit;
- Janë pranuar 702 fatura kontrata vendime të vitit 2022 janë protokolu dhe me kërkesë zotimi janë dorëzuar për zotim;
- Janë dorëzuar në divizionin e pagave 162 kërkesa për aktivizim të llogarive dhe regjistrimin në sistem të përfutësve të ri.

III . Sektori i Tatimit në Pronë

- Ofrimi i shërbimit qytetarëve për kryerjen e detyrimeve tatimore nga tatimi mbi pronë;
- Ofrimi i shërbimit për pagesën e taksës komunale për automjete dhe mbajtja shënimeve tjera;
- Ofrimi i shërbimit për biznese dhe punë të tjera sipas kërkesave të palëve;
- Dhënia e këshillave për palët në lidhje me kushtet e pagimit të tatimit;
- Gjatë periudhës së muajve Janar, Shkurt, Mars, Prill , Maj dhe Qershor të vitit 2022, janë shërbyer mbi 1200 palë me vërtetime, (1200 palë vërtetime për shërbime të Kadastra, nevoja personale dhe vërtetime sociale 395 palë dhe humbje të shtetësisë, korrigjim të emrit dhe mbiemrit 65 palë. Kërkesa për ndërrim të pronareve të objekteve janë 51 kërkesa;
- Janë inkasuar 190,794.60 € nga tatimi në pronë dhe 42,870.00 € nga taksa e automjeteve. Realizimi i planit 6 mujor për tatimin në pronë shprehur në përqindje është 32%, kurse tek taksa e automjeteve kemi realizuar planin për 71.45%. Këto mjete janë inkasuar vetëm me rastin e kushtëzimeve të dhënies së vërtetimeve për ZKK, kushtëzimeve për aplikime për grante bujqësore dhe nga lista prej 85 tatimpaguesve – borxhli të mëdhenj, e cila listë është dërguar të përmbareshi privatis në vitin 2018;
- Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi shumë 61,081.10 €, më pak inkasim nga tatimi në pronë;
- Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi 3,570.00 € më shumë inkasim nga taksa për automjete;
- Jemi në proces për zbatimin e planit të veprimit –përgatitjen e listës së 117 tatimpaguesve të mëdhenj dhe dërgimin e tyre të përmbareshi privat;
- Ri-anketim dhe Anketim rreth 1110 pronave sipas kërkesave të palëve;
- Rishikimi i lëndëve dhe shënimeve për tatim-paguesit gjatë viteve të tjera dhe punë të tjera administrative, duke përmirësuar shumë gabime në evidencat e bëra nga vitet e kaluara, duke verifikuar gjendjen në teren;
- Raportimi për të hyrat e realizuara nga tatimet dhe taksat në periudha të caktuara kohore-javore, si dhe

- Të hyrat nga Tatimi ne Prone janë të planifikuara deri në fund të vitit 2022, shuma prej 592,320.00 € të inkasuar janë 190,794.60 € shprehur në përqindje është 32.21 % nga Tatimi ne Prone, ndërsa nga Taksa Automjeteve Planifikimi është 60,000.00 € të Inkasuar janë 42,870.00 €, shprehur në përqindje është 71.45%.

IV. Sektori për ekonomi dhe zhvillim

Gjatë periudhës janar- qershor të vitit 2022 janë kryer këto punë:

- Kemi udhëhequr komisionin lidhur me hartimin e agjendës zhvillimore komunale për vitet 2022-2025;
- Kemi bërë dorëzimin e raportit të punës për vitin 2021 dhe planin e punës për vitin 2022;
- Kemi bërë shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për marrjen e pëlqimeve për shfrytëzimin e parcelave te Agjensionit Pyjorë dhe te pronave nën menaxhimin e AKP-së;
- Kemi bërë kërkesat pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit për marrjen e lejeve të kërkuara nga Zyra e Projekteve.

V. Zyra për regjistrimin e bizneseve

- Gjatë periudhës Janar - Qershor 2022 janë regjistru 91 biznese të reja;
- Gjatë kësaj periudhe janë shuar 21 biznese;
- Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 125 punëtorë.

VI. Projektet e investimeve kapitale për vitin 2022 të financuara nga buxheti i Komunës së Vitisë, buxheti i nivelit qendror dhe donacionet.

1	Asfaltimi i rrugës Viti-Sllatinë e Ultë	221,486.00
2	Asfaltimi i rrugëve rurale ne realizim e sipër nëpër vendbanime të komunës	370,000.00
3	Punimet në ujësjellësin për rritjen e kapaciteteve të ujit në Letnicë	30,000.00
4	Rregullimi i kanalizimeve në realizim te projektit	229,478.00
5	Rregullimi i rrugëve me zhavor ne realizim sipas dinamikes	351,000.00
6	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik në proces te realizimi	370,000.00
7	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese – publike ne proces te realizimit sipas dinamikes	100,000.00
8	Rregullimi i fushave sportive ne proces të realizimit sipas dinamikes se planifikuar	260,000.00
9	Rregullimi i lumenjve (kanaleve) dhe prrockave në proces te realizimit	120,000.00
10	Ndërtimi i urave në Pozheran dhe Buzovik	8,706.00
12	Riparime nëpër shkolla	200,000.00
13	Renovim i ambulateve ne proces te prokurimit	96,000.00
16	Furnizimi me aparatura dhe digjitalizim ne proces te projektimit	2,022.00
17	Pajisje mjekësore	21,000.00
18	Rregullimi i rrethojave te ambulateve	3,049.00
20	Rregullimi i rrugës Anton Qeta – Sejdiu, Stubëll e Epërme	150,000.00
23	Ndërtimi i shkollës fillore ne Pozheran ne proces te përfundimit	286,303.00
24	Palestra e sporteve ne Drobesh (Punimi i konstruksioni te kulmit me kapriate) ne proces te realizimit	250,000.00
26	Rregullimi i rrugës Viti-Korbliq-Kaqanik	700,000.00

27	Ndërtimi i infrastrukturës ne parkun industrial Budrikë	
28	Renovimi i objektit për inkubator të biznesit	494,253.00
29	Renovimi dhe zgjerimi i rrugës Kongresi i Manastirit në Viti	564,818.00
30	Rregullimi i ujës-jellësve në Komunën e Vitisë (CDI)	125,000.00
31	Ndërtimi i ambulantës në fshatin Goshicë	94,700.00
	Totali i përgjithshëm	4,576,766.00

Drejtoria për Inspeksion

Inspektorët e tregut

- Procesverbale në aspektin e zbatimit të ligjit për Nr:03/L-186, Ligjit 04/L005 , dhe ligjit 06/L-034 , kryesisht detyrim i legalizimit të veprimtarisë , ndërrimet e lokaleve , si dhe pajisjet me aktvendimet të pranimeve teknike..... 33;
- Inspektive në zbatim të masave- matje të peshës-sasinë e produkteve ne furrat e bukës, ku kryesisht janë verifikuar sasi të dhe është kërkuar që t'i shpallin deklacionet mbi peshën, çmimet dhe përmbajtjen e produkteve.....20;
- Kontrole mbi etiketën, deklacionin dhe flamurin e origjinës së produkteve.....15;
- Inspektive në fushën e kontrollit, identifikimit të rritjes së çmimeve të artikujve bazik, siç janë vaji dhe produktet tjera bazike, dhe në bashkërendim me institucionet e Inspektoratit të tregut ne kuadër të MTI-së dhe udhëzimeve të pranuar17;
- Inspektive mbi çmimet dhe sasinë e dhe llojin e furnizimit të plehut artificial në barnatoret bujqësore, ku janë evidentuar furnizuesit e shitësve me pakicë, çmimet, llojet dhe sasia ne dispozicion për fermerët10;
- Kontrole për ndalim të artikujve - lodra për fëmijë-imitim i rrezikshëm i produkteve ushqimore, kryesisht inspektimet janë fokusuar në veprimtarit gjithçka 1 €, por edhe ne supermarketet që posedojnë artikuj të tillë.....8;
- Inspektive në njoftim dhe largim i disqeve për prerje të metalit dhe betonit me afat të skaduar;
- Kontrole të autoparkimeve, ku janë urdhëruar që ti shpallin ne vend të dukshëm orarin e punës dhe çmimet e shërbimeve.....3;
- Kërkesa për pranime teknike të lokaleve.....22;
- Aktvendime për pranime teknike të lokaleve24;
- Procesverbale të komisionit për pranim teknik.....24;
- Kërkesa dhe pagesa mbi pranimin teknik të lokalit në shume prej1462.50 €;
- Kërkesë për punë shtesë nga Zv.kryeinspektorja e Inspektoratit të tregut.....1;
- Vizita tjera ne biznese ne aspektin e zbatimit të dispozitave të ligjit Nr:03/L-186 , dhe dispozitave tjera mbi peshën dhe njësitë matëse, çmimet e artikujve, shpallja e emërimit biznesit , kushtet e ushtrimit të veprimtarisë, e sidomos pajisje me pranim teknik të lokalit35.

Inspektori i komunikacionit

- Kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtuara nga qytetarë të ndryshëm, si dhe subjekte, si Operatorët e Transportit, po njashtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjithë përfaqësuesit e Auto-Shkollave, dhe subjektet tjera që ishin të lidhur apo të interesuar për Gjendjen në Komunikacion, si Shoqëri civile Media etj;
- Kemi menaxhuar furnizimin dhe vendosjen e shenjave të Komunikacionit sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës në tërë territorin e komunës së Vitisë, ku kemi vendosur 42 vendkalime të këmbësorëve, 130 m vije e mesit e ndërpre, 360 m vijë e plotë anësore. Si dhe 15 shenja te komunikacionit vertikale , dhe 14 shtylla te zinguar te shenjave te komunikacionit në riparim;
- Kemi hartuar 7 (Shtatë) procesverbale sipas detyrës zyrtare;

- Kemi hartuar 22 Procesverbale mbi shikimin e Automjetit për transport publik –Taxi;
- Kemi bërë 25 fletëpagesa për taksa komunale dhe atë mbi shikimin e automjetit-22x10, për Autobusa-2x20, dhe për Pëlqime për kyqje në rrugë 1x20;
- Kemi lëshuar me procesverbal LEJE për vendosjen e pengesave në Rruga "Hasan Prishtina" në Viti.

Udhëheqësi i sektorit për inspektime dhe uzurpime

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 janë kryer punët dhe detyrat nën mbikëqyrjet inspektuese si vijon:

- Kompletimin e lëndëve në lëminë e uzurpimeve të tokës në pronësi publike-komunale;
- Evidentimin e rasteve të reja sa i përket Uzurpimeve të pronës publike;
- Lirim të pronës së uzurpuar publike dhe lirim të hapësirave publike me qëllim të relizimeve të investimeve në infrastrukturë publike nga ana e institucione komunale;
- Inspektimet së bashku me inspektorin e tregut lidhur me inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, mbrojtjen e konsumatorit;
- Inspektimet e punimeve dhe pajisjes me leje përkatëse nga Ministria dhe sipas kërkesave për raste konkrete, si dhe ndalimi i punimeve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme;
- Inspektimi së bashku me inspektorin e Ambientit dhe Shërbimeve publike rreth ndotësve të ambientit, inspektimi i tregjeve, rrugëve, trotuareve, e sidomos inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale;
- Inspektimi së bashku me inspektorin e Ambientit dhe Shërbimeve publike sa i përket shfrytëzimit të hapsirës publike nga lokalet në Viti dhe Pozharan, dhe obligimi i tyre për tu pajisur me leje përkatëse nga Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave të Drejtorit të drejtorisë dhe obligimeve ligjore për inspektime në teren;

Gjatë periudhës raportuese Janar - Qershor 2022 në kuadër të Sektorit për Inspektime janë realizuar këto aktivitete nga Udhëheqësi i Sektorit e të cilat janë të veçanta nga inspektimet e përbashkëta:

➤ Inspektime	24
➤ Procesverbale.....	16
➤ Kallëzime penale.....	01
➤ Kërkesa për lirim të hapësirës publike.....	07
➤ Kërkesa dhe përgjigje të ndryshme	05

Inspektori i mbrojtjes së mjedisit

➤ Procesverbale të shkruara në teren	33
➤ Deklarata në Policin e Kosovës lidhur me vjedhje të aseteve të pronës publike.....	01
➤ Shpërndarje të njoftimeve për mbrojtjen e Mjedisit	10
➤ Inspektime në teren në gjithë territorin e Komunës së Vitisë.....	193
➤ Vendosja e tabelave ndalohet hedhja e mbeturinave.....	6
➤ Trajtimi i qeneve endacak me kastrim vaksinim dhe hospitalizim	111
➤ Trajtim me eutazi, transpot dhe groposje.....	28
➤ Trajtim me largim nga rruga dhe vorrosje	6
➤ Rast për polici dhe prokurori për marrjen e dheut në bankinat e lumit Morava	1
➤ Trajtim me eutazi, transpot, dhe groposje	28
➤ Trajtim me largim nga rruga dhe vorrosje	6
➤ Rast për polici dhe prokurori për marrjen e dheut në bankinat e lumit Morava.....	1
➤ Dalje në teren lidhur me mbeturinat në hapësira publike	35
➤ Dalje në teren pas përfundimit të orarit të punës.....	6
➤ Gjaba mandatare të shqiptuara sipas Rregullores komunale për Gjaba dhe ngarkesa.....	8
➤ Konsultime me pale në zyrë lidhur me kërkesat e tyre.....	73

Inspektori i shërbimeve publike

➤ Procesverbale të shkruara në teren	50
➤ Deklarata në Policin e Kosovës lidhur me vjedhje të aseteve të pronës publike	03
➤ Shpërndarje të njoftimeve të bizneset që shfrytëzojnë hapësirën publike komunale	50
➤ Inspektime të bizneseve se a janë pajisur me leje për shfrytëzim të hapësirave publike	50
➤ Dalje në teren me zyrtarin e ShP-së për matjen e hapësirave për dhënie të lejeve.....	10
➤ Dalje në teren me Zyrtarin KRU "HIDROMORAVA"	11

- Dalje në teren lidhur me mbeturinat në hapësira publike.....35
- Dalje në teren pas përfundimit të orarit të punës (KUJDESTARI)07
- Gjoha mandatare të shqiptuara sipas Rregullores komunale për Gjoha dhe ngarkesa....05
- Procesverbale me autorizim /nga inspektori I Uzurpimeve.....01
- Takime konsulatative me administratorët e fshatrave15
- Konsultime me pale në zyrë lidhur me kërkesat e tyre70
- Janë kryer edhe punë tjera se bashku me inspektoret e Agjensis së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Inspektori i ndërtimit

- Vizita në teren 60
- Procesverbale..... 21
- Vendime për ndërprerjen e punës 5
- Kallëzime penale..... 4
- Konsultime me palë 55

Gjeodeti

- Matje dhe Evidentime ne teren.....10
- Kopje planit.....8
- Asistime gjatë inspektimeve me Inspektorin e Ndërtimitarisë10
- Asistime gjatë inspektimeve me Inspektorin e Ndërtimitarisë5

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2022 ka pasur shumë detyra, obligime dhe përgjegjësi sipas planit të punës, e të cilat janë:

Sektori i shërbimeve publike

Për gjashtëmuorin e parë të vitit 2022 kemi pasur gjithsejtë 62 kërkesa të ndryshme nga ana e qytetareve, ku iu kemi përgjigje në afatin e duhur kohor.

Kemi lëshuar vendime dhe ngarkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike për vitin 2022, si dhe janë bërë pagesat për shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosjen e reklamave etj.

Kemi përcjell edhe punët e kompanisë për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve si: Pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, bartjen e disa kafshëve të ngordhura dhe varrosjen e tyre, mbushjen e gropave me kubza betoni nëpër rrugë të asfaltuara, mbushja e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara, furnizim me zhavor për rrugët e rendit të IV-të etj. Kemi përcjell edhe punët e kompanisë për mirëmbajtjen e ujësllësve dhe kanalizimeve në Komunën e Vitisë, të cilët nuk mirëmbahen nga kompania “Hidromorava”, ku për këtë periudhë kohore kemi pasur 58 intervenime në rregullime të kanalizimit dhe ujësllësit, zhblokime të kanalizimit etj.

Puna në zyrën Ligjore të Drejtorisë së Shërbimeve Publike

RAPORTI I PUNËS NË PERIUDHËN 6 MUJOR (03.01.2022 – 30.06.2022)				
Emri dhe mbiemri:	Driton Halabaku	Titulli:	Zyrtar Ligjor	Data: 13.07.2022
Aktivitetet	Sasia	Komentet		
Vazhdimi i Lejeve të punës për Auto Taxi dhe ndryshimi i te dhënave në leje	26			
Lejimi i lejeve të punës për Auto Taxi	1			
Leje për Pengesa në Rrugë	2			
Leje për Parkim të Rezervuar dhe përcjellja e tyre	2			
Përgatitja e propozim vendimeve dhe Vendime	8			
Licencë për autobus, vazhdimi i vija të udhëtimit për Autobus	2			

Mirëmbajta verore – dimërore e rrugëve lokale

Kemi përcjell punët të operatorit ekonomik SH.P.K “Zuka” për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve si: Pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, mbushjen e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara, furnizimin me zhavor nëpër rrugët e rendit të katërt, pastrimi i bankinave të rrugëve lokale nga barojat dhe shkuret etj.

Mirëmbajtja e HHP

Mirëmbajtjen e HHP gjatë periudhës raportuese e ka bërë operatori ekonomik Shpk “Arbor Group” nga Kamenica.

-Janë përcjelle punët për mirëmbajtje dhe pastrim të qytetit dhe HHP, në bazë të kontratës dhe paramasë.

Me Hapësira të Hapura Publike (HHP) të përfshira në këtë projekt nënkuptohen të gjitha sipërfaqet publike me rendësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytetin e Komunën e Vitisë.

Janë mirëmbajta: Parqet, Sheshet, Shëtitorja Viti-Bince, Shtrat i lumit Morava, Sipërfaqe gjelbëruese, Hapësirat për parkim automjesh, Hapësirat për-rreth objekteve sakrale (fetamumentale, rrugët, trotualet, tregjet, lapidarë, pllakat përkujtimore, Varrezat e Dëshmorëve dhe varrezat e qytetit të Vitisë. Është bërë edhe krasitja e drunjeve dekorativ në qytet, mbjellja e drunjeve dekorativ, mbjellja e luleve në qytet etj.

						13.07.2022
Nr.	Aktivitetet	Numri i lëndëve	Lëndë të miratuara	Lëndë të refuzuara	Lëndë në proces	
1	Leje të reja dhe ngarkesat për shfrytëzuesit e hapësirave publike para lokaleve dhe kafiterive	27	17	-----	10	
2	Vendimet dhe ngarkesat nga vendosja e reklamave në hapësirë publike	5	5	-----	-----	
3	Leje të reja dhe ngarkesat për vendosje të reklamave në hapësirë publike	5	5	-----	-----	
4	Vendimet dhe ngarkesat për dëmtim të infrastrukturës nga kyqjet në infrastrukturë Komunale	7	7	-----	-----	
5	Leje të përkohshme për shfrytëzuesit e hapësirave të ndryshme publike	5	5	----	-----	
6	Leje dhe ngarkesa për furnizim me ujë për pastrim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike	2	2	----	-----	
7	Kërkesa të ndryshme	14	9	3	2	
	Gjithsejt:	65	50	3	12	

Pastrimi i objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore

Me pastrimin e objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore, është marrë kompania „Aroma Plus shpk & Krasniqi Shpk & Ntp Beni nga Prishtina. Të gjitha objektet komunale shëndetësore dhe arsimore janë mirëmbajta sinas kontratës dhe përmasës .

Ndriçimi publik

Ndriçimi publik gjatë vitit 2022 në Viti dhe lokalitetet e Komunës sonë është duke mirëmbajtur nga operatori shpk. ATC COM -Kaçanikë, në bazë të kontratës dhe paramasës. Vazhdimisht kemi intervenuar ne sanimin dhe eliminimin e defekteve ne rrjetit e ndriçimit publik, kemi diku mbi 12.000 trupa ndriçues ne territorin e komunës sonë te cilët mirëmbahen.

Mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit

Me këtë projekt njëvjeçar mirëmbahen aparatet kundër zjarrit për NJPZ, institucionet komunale, arsimore dhe shëndetësore.

Ujësjiellësi dhe kanalizimi

Në komunën tonë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësjiellësit dhe kanalizimit, përgjegjëse është kompania regjionale "Hidromorava", njësi në Viti. Kompania ne fjalë, bënë furnizimin me ujë të pijshëm dhe mirëmban kanalizimin ne qytetin e Vitis, Drobesht, Ramnishte, Pozharan, Qifllak dhe Letnicë, ndërsa, ne lokalitet tjera ku rrjetet e ujësjiellësve dhe rrjetet e kanalizimeve nuk mirëmbahen nga kompania regjionale "Hidromorava", njësi në Viti, mirëmbahen nga operatori ekonomik "Vizioni BD," i kontraktuar nga Komuna e Vitisë.

Mbeturinat

Eco-Higjiena si kompani publiko-private, njësi në Viti, bënë mbledhjen, transportimin e mbeturinave në deponin regjionale ne Velekinc te Gjilanit dhe atë nga këto vendbanime të Komunës: Qyteti i Vitisë, Drobesht, Smirë, Terpezë, Pozheran, Sllatinë e Eperme, Slatine e Ulët, Radivojcë, Fshati Ri, Budrik, Remnik, Ramjan, Beguncë, Kabash, Germovë, Sodovin e Jerlive, Sadovin e Qerkezeve, Verban, Ramnisht, Goshicë, Skifteraj, Terstenik, Podgorc, Stubëll e Epërme, Lubishte, Binqe, Devaje dhe Qifllak, Letnicë.

DEPONITË ILEGALE

Deponi ilegale janë 9, ndërsa gjatë kësaj periudhe 6 mujore janë pastruar 6 prej tyre.

Sektori i emergjencave

1. Azhurimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike në rast fatkeqësish. (janar-mars).
2. Punët e përditshme administrative.
3. Takimet me QRAK-pandemia nga 12 mars deri tash.
4. Koordinimi rreth zjarreve me NJPZSH.
5. Implementimi i Vendimeve të Kryetarit të Komunës në Komisione Komunale, (raportimi per performancë dhe komisione tjera komunale).
6. Dalja ne vlerësimin e rreziqeve për 3 raste.
7. Azhurimi i të dhënave dhe dërgimi në AME.
8. Daljet e NJPZSH, gjithsej: 112, (zjarre 90, teknike 5, shërbime 13, aksidente rrugore 2 dhe vërshime 2

NJESIA PROFESIONALE E ZJARRFIKJES DHE SHPETIMIT VITI

Realizimi I numrit te përgjithshëm te daljeve, struktura e zjarreve dhe int. tjera ne periudhën Janar-Qershor deri me datën 21.06.-2022 nga Njësi e Zjarrfikësve në Viti.

deri me datën 21.06.-2022 nga Njësi e Zjarrifikësve në Viti.

Realizimi I numrit te përgjithshëm te daljeve, struktura e zjarreve dhe int. tjera ne periudhën Janar-Dhjetor 2022														
2022	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidentet rrugore	Vërshime	Të rejs h	Të lënduar			Të vdekur			Giths ejt
								zj .	qy t.	to t	zj .	qy t.	to t	
Janar	12	9	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12

Shkurt	11	9	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	11
Mars	43	40	0	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	43
Prill	28	22	1	4	1	0	0	0	3	3	0	0	0	28
Maj	18	10	2	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	18
Qersho r	25	9	7	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	25
Korrik														
Gusht														
Shtator														
Tetor														
Nëntor														
Dhjetor														
Gjithse jtë	137	99	12	22	2	2	0	0	3	3	0	0	0	137

Inspektori i preventives ndaj zjarrit

Për: AME dhe DSHPE

Aktiviteti i Preventivës ndaj Zjarrit në formë të shkurtuar për periudhën 01.01.2022 deri 15.06.2022

Inspektime të përgjithshme (të rregullta dhe verifikuese).....	27
Inspektime në sektorin privat.....	25
Inspektime në sektorin shoqëror(publik).....	2
Nr. vërejtjeve	49
Nr. Propozimeve të masave.....	49
Shikime në vendngjarje të zjarreve.....	9
Raporte zjarri për njësitin hetues në polici(prokurori).....	6
Kërkesa nga palët.....	7
Vërtetime zjarri për palët e dëmtuara.....	3
Pëlqim në dokumentacionin investivo teknik	1

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Vitin 2022 QKMF në Viti ka filluar me ofrime të shërbimeve shëndetësore, si dhe me planin vjetor dhe aktivitete tjera duke u fokusuar në:

- Ofrim të shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë, përfshirë qytetarët e Komunës së Klllokotit që kërkojnë shërbime në QKMF;
- Implementimi i mjekësisë familjare, duke zbatuar konceptin e mjekësisë familjare dhe duke u bazuar në normat ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Udhëzimeve Administrative;
- Ngritjen e cilësisë në të gjitha shërbimet shëndetësore;
- Furnizim më të mirë me terapi sipas listës esenciale, të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Furnizim me aparaturë mjekësore dhe inventar për kushte me të mira të punës;
- Trajnime dhe ligjerata të stafit shëndetësorë, bazuar në planin vjetor të ZHVP-së, si dhe trajnime tjera nga organizata te ndryshme si të mjekëve ashtu edhe të infermiereve;
- Menaxhim i pandemisë Covid-19 dhe menaxhim i vaksinimit kundër Covid -19.


- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka kryer shërbime që të jetë sa më afër qytetarëve dhe të jenë në shërbim të kërkesave të tyre, duke u munduar që të rregulloj sadopak mirëqenien e tyre si në aspektin shëndetësor, ashtu edhe në atë social dhe psikologjik.

Komuna e Vitisë ka rreth **46989 banorë** rezident, sipas ASK të vitit 2011.

QKMF në Viti ka filluar punën në vitin 1954. Në fillim kanë **qenë 17 punëtorë, 4 mjek, 10 infermier dhe 3 punëtorë teknik.**

Sot QKMF në Viti ka të punësuar **132 punëtorë, prej tyre 29 mjekë, 85 infermier dhe 18 punëtorë teknik dhe administrate.**


Më poshtë është i paraqitur oganogrami I QKMF-së në Viti:



QMF-të dhe AMF-të të cilat kanë funksionuar gjatë kësaj periudhe në Komunën e Vitisë janë:

1. QMF-Pozheran
2. QMF-Sllatinë e Epërme
3. QMF-Smirë
4. QMF- Sadovinë e Jerlive
5. AMF-Beguncë
6. AMF-Skifteraj
7. AMF-Stubëll
8. AMF-Tërpezë
9. AMF -Letnicë
10. AMF- Remnik
11. AMF Zhiti-jofunkionale

Me poshtë është i paraqitur organogrami i institucioneve shëndetësore në Komunën e Vitisë:



Gjendja në terren:

1. Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Pozheran punohet 24 orë pa ndërprerë. Në kuadër të kësaj qendre ofrohen të gjitha shërbimet e mjekësisë familjare, si dhe shërbime stomatologjike, por edhe kryhen analiza të ndryshme laboratorike gjatë ndërrimit të parë, gjithashtu ka funksionuar hapësira e veçantë për COVID-19;
2. Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme ofron shërbime infermierike dhe mjeku 1 ditë në javë;
3. Në QMF-në në fshatin Smirë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike, ndërsa mjeku një ditë në javë;
5. Në QMF-në në fshatin Sadovinë të Jerlive punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike, ndërsa mjeku një ditë në javë;
6. Në AMF-në e Skifterajt punohet dhe ofrohen shërbime çdo ditë punë nga ana e infermierëve përveç vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë;
7. Në AMF-në e fshatit Beguncë ofrohen shërbime infermierike çdo ditë punë përveç vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë;
8. Në fshatin Tërpezë shërbimet mjekësore ofrohen çdo ditë punë nga infermieret, ndërsa mjeku dy ditë në javë;
9. Në AMF-në në fshatin Stubëll e Epërme punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë;
10. Në AMF-në në Letnicë shërbimet shëndetësore nga infermierja dhe mjeku ofrohen njëherë në javë;
11. Në AMF-në në fshatin Remnik punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë.

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare bëhet ofrimi i shërbimeve mjekësore për qytetarë sipas këtyre kategorive mjekësore:

1. Shërbimet primare:

- a. Mjekësia Familjare
- b. Emergjenca
- c. Stomatologjia
- d. Imunizimi
- e. Diagnostika (Laboratori dhe Shërbimi Radiologjik)
- d. Barnatorja

2. Shërbimet specialistike

- a. Pediatria
- b. Shërbimi i sëmundjeve të brendshme (Internisti)
- c. Gjinekologjia

Në QKMF në qytetin e Vitisë punohet 24-orë. Të gjitha shërbimet mjekësore familjare, stomatologjike, pediatrike, interne, radiologjike dhe laboratorike kryhen vetëm gjatë ndërrimit të parë të orarit të punës. Qendra e emergjencës punon gjatë 24 orëve për çdo ditë të javës, ndërsa mjekësia familjare punon në orarin 8:00-22:00.

1.1. Mjekësia Familjare

- Ka ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët e komunës së Vitisë dhe të një numri të konsiderueshëm të Komunës së Kllokotit të të gjitha moshave pa dallim. Në këtë periudhë janë ofruar 19961 vizita mjekësore.

1.2. Emergjenca

Shërbimi i Urgjencës ofron shërbime shëndetësore **24 orë** ditë, gjatë tërë javës. Në shërbimin e urgjencës kryhen të gjitha shërbimet e ndihmës së parë, kirurgji e vogël, ndërrim kateteri, lidhje dhe pastrim i plagëve etj;

- Në këtë shërbim janë të organizuara edhe kujdestaritë gjatë natës , vikendeve dhe festave , në bazë të orarit të planifikuar më parë;
- Autoambulancat janë monitoruar në vazhdimësi nga ekipet kujdestare dhe vozitësit, në drejtim të funksionimit sa më të rregullt të saj. Ne dispozicion kemi 6 autoambulanca;
- Në këtë periudhë janë ofruar 22820 vizita mjekësore në shërbimin e urgjencës.

1.3. Stomatologjia

Shërbimi i stomatologjisë ka ofruar shërbime ne orarin 8:00-15:00. Këto shërbime ofrohen ne QKMF-Viti dhe QMF- Pozheran,

Shërbimet të cilat ofrohen janë:

- Preventivë
- Shërim i dhëmbit
- Drenim
- Incizon i dhëmbit të infektuar
- Mbushje e dhëmbit
- Shërbimet e pedodoncisë,
- Nxjerrje e dhëmbit etj.

Gjatë kësaj periudhe janë ofruar 1561 shërbime stomatologjike.

1.4. Shërbimi i Vaksinit

Shërbimi i vaksinit në mënyrë te vazhdueshme ka punuar në ngritjen e cilësisë profesionale të stafit shëndetësor, po ashtu edhe në edukimin e qytetareve në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e promovimit dhe parandalimit të sëmundshmërisë së fëmijëve dhe rëndësinë e vaksinit ne fëmijëri.

Ka bërë planin vjetor dhe ka realizuar planin ne përpikëri ne vaksinimin e fëmijëve parashkollor dhe shkollor në tërë territorin e Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kllokotit.

Gjithashtu, shërbimi i vaksinit, me ardhjen e vaksinave në Kosovë kundër Covid-19, me ndihmën e stafit shëndetësor te dërguar nga Ministria e Shëndetësisë, ka bere vaksinimin e qytetareve me vaksinën anticovid.

Deri më sot për këtë 6 muor janë planifikuar te vaksinohen 1935, ndërsa janë vaksinuar 1907 fëmijë, ndërsa në këtë 6 muor janë vaksinuar me vaksinën anticovid 3513 qytetarë.

1.5. Laboratori dhe shërbimi radiologjik

Shërbimi laboratorit ofron shërbime ne orarin 8:00-15:00. Këto shërbime ofrohen ne QKMF-Viti dhe QMF- Pozheran,

Është bërë furnizimi me material të nevojshëm për funksionimin normal të Laboratorit.

Janë ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë pacientët të cilët kanë kërkuar shërbime laboratorike në institucionin tonë

Gjatë periudhës janar-qershor 2022 janë bërë 65634 analiza.

Janë bërë 6243 teste rapide ne këtë periudhë.

Rentgeni punon ne orarin e rregullt 8:00-13:00, gjithashtu edhe ditën e shtune. Disa muaj shërbimi radiologjik nuk ka punuar për shkak te defektit.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë 379 incizime radiologjike.

1.6. Barnatorja

Është bërë planifikimi me kohë për furnizim me barna dhe material hargjues për vitin 2022,

Janë kryer në mënyrë të rregullt porositë mujore për furnizim me barna dhe materialhargjues nga Ministria e Shëndetësisë, kryesisht përmes sistemit SMFK.

Është bërë distribuimi i barnave dhe materialit hargjues në QKMF dhe QMF-Pozheran si dhe te gjitha AMF-të.

Është bërë furnizimi i pacientëve me barna esenciale dhe insulinë,

Gjatë kësaj periudhe kemi blerë me mjete vetanake, përmes kontratës me operatorin ekonomik në kuadër të shërbimeve dhe mallrave terapi dhe material hargjues në raste specifike në vlerë prej 26490 euro.
Është bërë asgjësimi i të gjitha barnave me afat të skaduar.

2. Shërbimet specialistike

2.1. Pediatria

Shërbimi i pediatrikës ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-15:00, çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore. Gjatë këtij 6 mujori janë ofruar 1747 vizita mjekësore.

2.2. Mjekësia interne

Shërbimi i mjekësisë interne ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-15:00, çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore kryesisht për të sëmurët kronik. Sëmundjet më të shpeshta kronike të evidentuara në shërbimin e mjekësisë interne janë sëmundjet kardiovaskulare, reumatologjike dhe diabetit. Gjatë këtij 6 mujori janë ofruar 414 vizita mjekësore.

2.3. Gjinekologjia

Shërbimi i gjinekologjisë ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-15:00, çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore për gratë shtatzëna. Gjatë këtij 6 mujori janë ofruar 848 vizita mjekësore dhe 820 ultrazë.

Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë

Kujdesi për nëna dhe fëmijë ka vazhduar kryesisht në mënyrë virtuale dhe të drejtpërdrejtë në shtëpi, ku gjatë këtij 6-mujori janë kryer 497 vizita.

Sistemi Informativ Shëndetësor

Janë raportuar me kohë të gjitha raportet në të gjitha institucionet përgjegjëse si IRSHP -Gjilan , IKPSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Është përcjellë gjendja e sëmundshmërisë përmes formularëve të caktuar dhe është raportuar me kohë në institucionet përgjegjëse.

Gjithashtu, është përcjellë dhe raportuar në mënyrë ditore edhe procesi i testimeve me RAT si në IRSHP-Gjilan, po ashtu dhe IKPSH.

Tabela e raportit të SISH për periudhën Janar - Qershor 2022

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE "NËNE TEREZE"-VITI

RAPORT GJASHTMUJOR JANAR - QERSHOR 2022

Repartet	Vizita	Vizita sht	Vizita C	Therrije	Infuzion	Transfe	Transf Diag	Lidheje	Inhalime	Këshilla	Ekg	Nr. Analiz	Ndrrim i	Dhune fa	Nr. Xerri	Pagesa	L. Pagesa
Emergjencia	22820	497		15992	8306	2255		718			418			4		4385.5	18384
Mjekësia Familjare 1	13135			4529		1767										4972	12516
Mjekësia Familjare 2	4949					816										970	3978
Mjekësia Familjare 3	1877					326										451	1436
Stomatologjia	1254													307		190	1118
RTG	379															412	260
Dhoma e Inf Covid			2345	323	334												2372
Dhoma e Infuzioneve					1111											317	794
Laboratori	5925											59709				3781	4654
Pediatri	1747					25	41			136							1747
Interno	414										216					226.5	568
Ekipa e terenit Caritas		588		205	160			112					162				588
Ekipa e terenit QKMF		712		142	436			35					86				712
Kontrolla Gjinekologjike	848			142		54				323						555	1152
Vizita per nene dhe femijen		497															497
Shërbimi i Vaksinimit	2628			5328													2628
Vaksinimit Covid 19	3507			3517													3507
Inhalime ne QKMF Viti									173								173
Lidhtorja								1189								128	1143
TOTALI	59483	2294	2345	30178	10347	5243	41	2054	173	459	634	59709	248	4	307	16388	58227

NUMRI I VIZITAVE NE AMBULLANTAT E QENDRES KRYESORE TE MJEKËSISË PRIMARE

Amb. Smirë	14			30				33	7	264						3	346
Amb. Sadovin	3			13				8		11						2	32
Amb. Sllatin	33			172	157			135	4	17						30	487
Amb. Pozheran Covid			94		114												130
Amb. Pozheran	19529			7315	4885	2485		949	94		195					6370.5	13085
Laboratori Pozheran	2753										24830					1036	2386
Stomatologjia pozheran	357													145		36.5	334
Amb. Tërpez	37			94	61			107	19	112						19	417
Amb. Gjylekar	31			52	11	1		11	1	75						16	166
Amb. Beguncë	22			29	15			74	5	77							221
Amb. Remink				6	11			25		4							46
Amb. Letnic	70			7													70
Amb. Stubell	501			180				44	4	51						2	519
TOTALI	23350	0	94	7898	5254	2486		1386	134	611	195	24830	0	145		7515	18239

	59483	2294	2345	30178	10347	5243	41	2054	173	459	634	59709	248	4	307	16388	58227
	23350		94	7898	5254	2486		1386	134	611	195	24830			145	7515	18239
GJITHSEJ TOTALI	82833	2294	2439	38076	15601	7729	41	3440	307	1070	829	84539	248	4	452		
GJITHSEJ SHËRBIME																23903	76466

Raportet Statistikore

E-mail: Zekirja.mustafa@gmail.com

Vaksina Doza I	738	Grip Sezonal 68
Doza II	1165	
Doza III	1610	

Kordinatori i S.I.S.H
Zekirja Mustafa

Drejtori QKMF
Dr. Vjollca Kadolli Halili

Kujdesi paliativ

Shërbimi i kujdesit paliativ ka kryer me profesionalizëm shërbimet shëndetësore ndaj pacientëve me sëmundje kronike, dhe atyre të pa lëvizshëm. Në QKMF Viti funksionojnë dy ekiye në teren, në orarin 8:00-15:00, ndërsa prej orës 15:00 vizitat në teren i kryen shërbimi i urgjencës. Gjithashtu, është edhe mjeku në permanentë, i cili aktivizohet në punë varësisht nga rastet ditore, kur ka nevojë për shërbim të mjekut. Varësisht nga kërkesat janë kryer edhe vizitat në shtëpi për të sëmurët me Covid -19. Gjatë këtij 6 mujori janë ofruar 3127 shërbime shtëpiake.

Situata me covid-19 në Komunën e Vitisë

QKMF në Viti në vazhdimësi ka qenë e fokusuar në menaxhimin e situatës me COVID-19. Ka ndarë hapësirën për trajtimin e pacientëve me COVID dhe autoambulancën, e cila ka shërbyer për transportin e pacientëve me COVID-19.

Është bërë raportimi ditor i rasteve të testuara për COVID-19 në IRSHP dhe në IKSH. Është marrë anketa e secilit qytetarë të infektuar dhe është bërë përcjellja e gjendjes shëndetësore për secilin pacient dhe janë organizuar vizita dhe këshilla varësisht nga nevoja.

Në tabelë mund të shohim numrin e personave të prekur nga Covid-19 që nga 13.03.2020- 01.07.2021.

Rastet e testuara për COVID-19 në Komunën e Vitisë prej 13.03.2020	
Komuna e Vitisë	Nr.
Testime në komunën e Vitisë	17070
Raste Pozitive	4102
Raste aktive	1
Raste negative	3988
Te vdekur	103

Cilësia e shërbimeve shëndetësore:

- Janë mbajtur takime të rregullta të Këshillit Drejtues të QKMF-së në Viti.
- Janë mbajtur takime me përgjegjësit e njësive, në mënyrë të evitimit të parregullsive dhe avancimit të shërbimeve sa më cilësore.

Edukimi i vazhdueshëm profesional

Ka vazhduar edukimi i vazhdueshëm profesional nga ana e mjekëve dhe infermierëve sipas planifikimit të temave profesionale që janë dërguar më parë për akreditim në odën e mjekëve dhe infermierëve (OMK dhe OIK).

- **Nga mjekët** janë mbajtur **6 ligjërata**.
- Nga Infermierët janë mbajtur 6 ligjërata me 2 grupe nga 30 infermier, në total 360 infermier të trajnuar.

Promovimi dhe edukimi shëndetësor në komunitet janë realizuar këto aktivitete :

- Është shënuar Dita Botërore kundër kancerit
- Është shënuar Dita Botërore kundër Tuberkulozit
- Është shënuar Dita e Shëndetit
- Është shënuar Java e Imunizimit
- Është shënuar Dita e Infermierit
- Është shënuar Dita e Mjekut Familjare
- Është shënuar Dita Botërore kundër duhanit
- Përcjellja e të gjitha aktiviteteve sportive në Komunën e Vitisë

Donacionet

- Përfitimi i objektit të ri të AMF në Goshicë nga donatori “ Kuëait Society for Relief”, në vlerë prej 94700 euro.
- Donacionet nga Unicef për qendrën e vaksinimit , material higjienik
- Donacion nga Caritas Kosova, 20000 maska për fytyrë
- Donacion nga Rotary Club Viti, maska, dorëza, termometra, pulsoksimetra, dezinfektues dhe çarçafë.
- Donacion nga Unicef 2 frigorifer për vaksinim dhe 50 karrige për qendrën e vaksinimit në Viti

Investimet

- Ka filluar renovimi i QKMF, QMF- Pozheran dhe AMF-ve
- Ka filluar ndërtimi i AMF në Goshicë

Shërbimet shëndetësore të ofruara gjatë periudhës janar-qershor 2022, shih tabelat në vijim

Tab.2.1. Tabela Kryesore e të gjitha shërbimeve për periudhën janar-qershor 2022

Nr	Shërbimet	Totali	Nr.referimeve dhe %
1	Vizita në mjekësinë familjare	19961	
2	Vizitat në Emergjencë	22820	
3	Vizitat shtëpiake –Shërbimi Emergjent	497	
4	Vizita Stomatologjike	1254	
5	Shërbime laboratorike	65634	
6	Shërbime të Kujdesi Paliativ	2638	
7	Vizitat ne QMF Pozheran dhe AMF	19529-Pozherani	
8	Vaksinimi i fëmijëve	3821 AMF tjera	
9	Vaksinimi anticovid	1907	
10	Vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë	3507	
11	Participimi i përgjithshëm	497	
12	Totali i Vizitave	23777.9	
13	Shërbimet tjera shëndetësore	82833	
14	Totali i ofrimit të shërbimeve nga QKMF për qytetaret e Komunës së Vitisë	149299	
		232132	

Në QPS-Viti, gjatë gjashtëmujorit të parë nga 01. 01.30. 06. 2022, punët kanë rrjedhë në përputhshmëri me planifikimin dhe masat e ndërmarrja, janë përmbushur të gjitha detyrat shtesë, në ofrimin të shërbimeve për kategoritë e rrezikuara, që përfshihen në domenin e punës sociale, siç janë shpërndarja e 200 pakove ushqimore dhuruar nga organizata humanitare Jetimet e Ballkanit, futja. Numri i punëtorëve të angazhuar në QPS gjatë kësaj kohe është 1, nga të cilët 3 punëtorë me kontratë të përkohshme, njëri nga këta 13 punëtor ka shkuar në pension, njëri nga punëtorët me kontratë i ka skaduar afati kontratës, për momentin janë të angazhuar 11 punëtor punëtor aktiv, Drejtori QPS-së, 3 punëtor të shërbimit, social, Udhëheqësi i Shërbimit të asistencës dhe 3 punëtor të shërbimit, 1 punëtor i administratës dhe financave dhe 2 punëtorë

<i>Kategoritë e shërbimeve sipas rasteve</i>	<i>Raste të reja</i>	<i>Përsëritje</i>	<i>Të bartura nga vitet tjera</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Vendosja në institucione - Vërejtje</i>
Raporte të çrregulluara bashkëshortore-Besim i fëmijëve	5	0	8	13	
Te mitur në konflikt me Ligjin	22	1	48	71	
Dhuna në familje	8	0	15	23	
Te mitur me sjellje asociale	1	3	8	12	
Fëmijët e keqtrajtuar fizikisht	0	1	5	6	
Kujdestari e fëmijëve	0	1	21	22	
Fëmijët në strehim. Familjar tek të afërmit	0	0	9	9	
Fëmijët e vendosur në famil. strehues	0	0	2	2	
Adoptimi i fëmijëve	2	0	3	5	
Kontaktimet prind-fëmijë	3	0	15	18	
Keqtrajtimet-ngacimet sex.të fëmijëve	1	0	2	3	
Te moshuar pa përkujdesje familjare	0	0	4	4	3-SHPMPF
Fëmijët me nevoja të veçanta	3	0	49	52	ne Shtime,2 ne Ferizaj 2 dhe ne Kamenice 1
Te rritur me nevoja të veçanta	1	0	5	5	100 euro mujore 2 muaj plus 60 euro
Ftesa gjyqësore për të mitur	7	0	0	7	
Ftesa gjyqësore për territor	6	0	0	6	
Lypës të rrugës	0	0	0	0	
Masat e shqiptuara për të mitur; M.SH.P	3	0	0	3	
M.O.K	1	0	0	1	Organi Kujdestarisë
Qortim	6	0	0	6	
Burg	2	0	0	2	
Vërtetime për nënshtetësi	10	0	0	10	

Vërtetime të zotësisë së veprimit - për armë	43	0	0	43	
Vërtetime të zotësisë së veprimit - për punë	12			12	
Fëmijët në punë të rënda	0	0	0	0	
Ankesa koms.mj.shk.II	0	0	0	0	
Fëmijët e vendosur ne institucionet mbrojtëse	0	0	1	1	
Vendosja stre-dhunë familje	1	0	0	1	
Regjistr.i mëvonshëm i fëmijëve	0	0	0	0	
Përdorues te narkotikeve	0	0	1	1	
Martesa e parakohshme	2	0	0	4	
Urdhër mbrojtje për viktimat e dhunës ne familje	0	2	2	2	
Shërim i detyrueshëm psikiatrik	1	0	0	1	
Kërcenim	1	0	0	1	
Trafikim	0	0	0	0	
Fëmijët e braktisur të porsalindur	0	0	0	0	
Raste tjera në nëvojë për shërbime	1	0	0	1	
Gjithsej raste te trajtuar dhe shërbimet e ofruara	141	8	189	338	

me kontratë. Gjatë këtij 6 kishite konkurs të hapur edhe për plotësimin e vendit të punës Udhëheqës i Shërbimit Social në sistemim I brendshëm në nivel koeficienti por nuk ka konkurruar askush.

Shërbime të asistencës

Nuk kemi raport për muajt veç e veç dhe në tersi kemi pasur defekte në sistem. Përafërsisht shuma e njëjtë me vitin e kaluar

Shuma e e përafërt është shënuar te llogaria totali pasi këtij vit një muaj më pak janë dhënë dy pagesa.

<i>Pasqyra e pagesave nga shërbimi i asistencës gjatë këtij nëntëmuajori</i>			
<i>Nr.</i>	<i>Muaji</i>	<i>Numri familjeve</i>	<i>Pagesa mujore</i>
1.	Janar	501	108042.50 €
2.	Shkurt	508	109662.50 €
3.	Mars	506	109250.00 €
4.	Prill	482	66369.00 €
5.	Maj	486	67162.00 €
6.	Qershor	486	67112.00
Gjithsej	5 muaj	Mesatarja 491 fmile mesatarja mujore	527597.00 € në totali 6 mujori 2022 shuma 4,1228.00 E

Gjitha rastet e shqyrtuara për Asistencë Sociale

<i>Të shqyrtuar</i>	<i>Të aprovuara</i>	<i>Të refuzuara</i>
85	57	26

<i>Rastet e shqyrtuara</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Aprov</i>	<i>Refuzuara</i>
<i>Aplikim për herën e parë</i>	19	16	3
<i>Riaplikim</i>	349	303	39
<i>Gjithsej</i>	368	319	42

Lëndët e shqyrtuar nga komisioni mjekësor

Lëndët e shqyrtuara sipas ankesës

<i>Te trajtuar</i>	<i>Aprovuara</i>	<i>Refuzuara</i>	<i>Gjithsej</i>
<i>Në shkallë të parë</i>	2 në shqyrtim	13	15
<i>Në shkallë të dytë</i>	5	2	5
<i>Në Gjykatë</i>	0	2 në shqyrtim	2
<i>Gjithsej</i>	3	4	7 në shqyrtim

Kërkesa për subvencione nga DPSF-DSAS

<i>Gjithsej</i>	<i>Të aprovuara</i>	<i>Të refuzuara</i>
3	2	1

Vërtetime të lëshuar brenda 5

muajve

<i>Me pagesë</i>	<i>Papagesë</i>	<i>Gjithsej</i>
152	00	152

Të atakuar nga ATK 20 familje

Vërtetime për student

<i>Gjithsej</i>	0
-----------------	---

Propozim pëlqimi për autorizim për tërheqjen e mjeteve

<i>Gjithsej</i>	0
-----------------	---

RAPORTI FINANCAR

Të hyrat vetanake financiare nga taksat komunale në QPS:

<i>Të inkasuara</i>	<i>Të dorëzuara</i>	<i>Gjithsej</i>
1.919.00 €	1.919.00 €	1.919.00 €

Drejtoria për Arsim

Në Viti, procesi mësimor zhvillohet që nga edukimi i hershëm çerdhet, parashkollorët, mësimi i ulët i mesëm dhe ai i lartë. Gjatë kësaj periudhe zhvillimi i procesit mësimor ka qenë i rregullt. Në fillim kemi pasur sfidat me mësimin online. Sipas rekomandimeve të Institutit dhe në koordinim me taskforcat e shkollave dhe të DKA-së, kemi arritur të bëjmë një organizim. Po ashtu edhe testime në masë nga QKMF-ja për nxënësit, duke u kujdesur për shëndetin e tyre dhe të mësimdhënësve. Gjatë periudhës së tretë mësimi është zhvilluar pa asnjë pengesë, përpos mësiminut edhe aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore janë organizuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

2 Realizimi i Aktiviteteve të planifikuara për Janar – Qershor

Janë organizuar aktivitetet të ndryshme sipas planit të punës së DKA-së dhe shkollave

Përgatitjet për fillimin e periudhës së dytë	Janar	DKA/IA
Shënimi me aktivitet të 17 shkurtit Ditës së Pavarësisë së Kosovës	Shkurt	DKA/IA
Shënimi i 7 Marsit Ditës së Mësuesit	Mars	DKA/IA
Shpallja e Javës “Edukimi për Barazi Gjinore”	Mars	DKA/IA
Raportim për Mungesa të Nxënësve dhe mësimdhënësve	Çdo muaj	DKA/IA
Aktivitetet dhe gara në fusha të ndryshme	Mars/Prill	IA
Shënimi i Ditës Ndërkombëtare DON SINDROM	Mars	DKA/IA
Pjesëmarrje në aktivitetet e “Flakadanit të Karadakut”	21-26 Mars	DKA/IA
Shënimi i Ditëve të Shkollave	Sipas ditës	DKA/IA
Aktivitetet për Ditët e Ambientit	Prill	DKA/IA
Përfundimi i periudhës së dytë dhe përgatitjet për periudhën e tretë	Prill	DKA/IA/MASHT
Aktivitete për Ditën Ndërkombëtare të Librit	23 Prill	DKA/IA/DKRS
Ligjërata nëpër shkolla, tematika edukative	Çdo muaj	DKA/Psikolog/Policia/QKMF/QPS
Organizimi i testit Pisa	Prill/Maj	DKA/IA/MASHT
Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të fëmijëve	1 Qershori	DKA/DKRS/IA
Organizimi i Testit të Arritshmërisë	Qershor	DKA/IA/MASHT

Organizimi i Aktiviteteve për ditën e Çlirimit	14 qershori	Komuna/DKA/IA
Organizimi I testit të maturës	Qershor	DKA/IA/MASHT
Aktivitete të tjera sipas kalendarit të MASHT, Institucioneve Lokale dhe akteve të tjerë që janë në interes për sistemin edukativo arsimor	Çdo muaj	DKA/IA/MASHT

Përgatitja e shkollave për fillimin e periudhës së dytë të viti shkollor 2021/22;

Periudha e dytë ka filluar me 10.01.2022;

Vizitë në shkolla dhe monitorimi i rregullt për vijueshmërinë e personelit arsimor dhe nxënësve;

Testi Pisa është mbajtur më 17, 18, 19. 05 2022, për tri ditë me këto shkolla:

SHFMU “Ahmet Hajdari”, SHFMU “Dëshmorët e Vitisë”, SHFMU “Njazi Rexhepi”, SHML Gjinnazi “Kuvendi i Lezhës”, SHML Profesionale “Januz Zejnullahu”, me 161 nxënës, të cilët kanë marr pjesë në testin PISA;

Testi TIMS është mbajtur me nxënësit e klasës së katërt të SHFMU “Bafti Haxhiu”, me gjithsej 42 nxënës;

Testi ICILS është mbajtur me nxënësit e klasës së tetë të SHFMU “Ndre Mjeda”, me gjithsej një klasë e tetë 22 nxënës;

Testi i Arritshmërisë me nxënësit e klasës së nëntë këtë vit është mbajtur në dy pjesë. Pjesa e parë është mbajtur më 04.06.2022 dhe pjesa e dytë është mbajtur më 14.06.2022. Në këtë test kanë marrë pjesë 590 nxënës;

Testi i Maturës është mbajtur më 18.06.2022, në katër qendra, ku morën pjesë 422 nxënës maturant dhe kalueshmëria është mbi 81 %.

3. Shërbimi psikologjik

- ❖ Është bërë evidentimi i rasteve (nxënësve), të cilët kanë nevojë për shërbim psikologjik;
- ❖ Vazhdim i psikoedukimit me nxënës, duke përfshirë fusha të ndryshme;
- ❖ Administrimi i testeve psikologjike (vlerësimi psiko-fizik i pjekurisë për klasën e parë);
- ❖ Mbajtja e seancave psikoterapeutike. Nxënësit janë trajtuar me këshillim psikologjik; teknika biheviore, psikoterapi pozitive, psikoterapi trupore, psikoterapi familjare etj.
- ❖ Punë e vazhdueshme me klasën e bashkëngjitur me nxënësit me nevoja të veçanta;
- ❖ Punë rreth parandalimit dhe braktisjes së shkollës;
- ❖ Takime me ekipin për vlerësim pedagogjik të nxënësve;
- ❖ Vlerësime pedagogjike për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
- ❖ Takime me prindërit e fëmijëve që kërkojnë mbështetje psikologjike për fëmijët e tyre;
- ❖ Bashkëpunim me QPS-në;
- ❖ Bashkëpunim me zyrtaret nga Policia e Kosovës;
- ❖ Vizita nëpër shkolla;
- ❖ Prezantim në takime, punëtori dhe trajnime;
- ❖ Takime në MASHT;
- ❖ Organizimi, mbajtja e trajnimit për kurrikulën për të gjitha fushat për vitin shkollor 2021/22;
- ❖ Vlerësimi i dosjeve të mësimdhënësve;
- ❖ Punë rreth recensimit të librave shkollor në bashkëpunim me MASHT-in;
- ❖ Ligjërata me Policinë e Kosovës në kuadër të kampanjës “Së bashku kundër bullizmit”.

4. Sektori i financave

- ❖ Brenda kësaj kohe kemi kryer obligimet nga viti 2021 në vlerë 113776.93€ (96758.00€ kapitale);
- ❖ Të gjitha shkollat me kohë janë furnizuar me material higjenik, material hargjues, material pune për zyra sipas kërkesave të shkollave;
- ❖ Po ashtu në këtë sektor janë bërë edhe ndryshimet në regjistrat e pagave, si: Futja e punëtorëve të rinj në listat e pagave, largime, pagesa retroaktive, ndryshime tjera, ndërrimet e llogarive bankare për punëtorët etj, e qe në total janë 233;
- ❖ Furnizimi me inventar për shkollat “Safet Rexhepi” në vlerë prej 8260.00€, “Dëshmoret e 5 Prillit” në vlerë prej 1850.00€, “Kongresi i Manastirit” në vlerë prej 2440.00€, “28 Nëntori” në vlerë prej 525.00€, “Nazmi Pajaziti” në vlerë prej 940.00€, “Bafti Haxhiu” në vlerë prej 2200.00€, “Kenan Halimi” në vlerë prej 1688.00€, “Mirali Sejdiu” në vlerë prej 4040.00€, Çerdhja “Gëzimi Ynë” në vlerë prej 3171.00€ dhe “Nijazi Rexhepi” në vlerë prej 580.00€. Gjithsej 29989.00€;
- ❖ Kemi bërë përgatitjen dhe shpalljen e tenderit dhe kemi fillu furnizim me lëndë djegëse (dru) për vitin shkollor 2022/23, sipas kërkesave të shkollave, ku parashihet sasia prej 3250M/H;
- ❖ Kemi përgatit dhe shpall tenderët për furnizim me perde dhe tepi, furnizimi me pajisje të imta;
- ❖ Kemi furnizuar gjitha shkollat me paralele të ndara me internet;
- ❖ Po ashtu këtë vit kemi planifikuar furnizimin e shkollave me pajisje për kabinete (projektor) në vlerë prej 37000.00€, dhe kemi shpallë tenderin;
- ❖ Është përgatitur korniza afatmesme buxhetore për vitet 2023-2025;
- ❖ Janë pranuar dhe shpërndarë listat e pagave dhe janë kompletuar me nënshkrime nga shkollat;
- ❖ Janë bërë pagesat e transportit për nxënësit me largësi nga shkollat fillore;
- ❖ Është bërë furnizimi me pajisje të imta, të nevojshme për shkollat dhe mirëmbajtja e tyre;
- ❖ Me projektin Efiquences në Energji “Nder Mjeda”, “Bafti Haxhiu” “Hysen Terpeza”
- ❖ Si dhe pune tjera me kërkesë të drejtorit.

5. Sektori i Administratës

Për këtë periudhë kohore prej 01.01.2022 deri më 30.06.2022 janë kryer këto punë dhe shërbime:

Gjithsejtë janë të protokolluara 581 lëndë të natyrave të ndryshme:

- Konkurse -----04
- Kontrata -----40
- Vendime -----64
- Propozim-Vendime-----01
- Përgjigje në padi -----101
- Ankesa drejtuar DKA-së ----- 4
- Padi për gjykatën Themelore --- 4
- Kërkesa nga palët-----215
- Përgjigje në kërkesa-----24
- Pëlqime-----20
- Njoftime të ndryshme -----13

- Vërtetime -----	30
- Urdhëresa -----	2
- Autorizime -----	61

Gjithsej 581 lëndë

6. Lendet e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- ❖ Në periudhën Janar - Qershor janë protokolluar 581 lëndë të natyrave të ndryshme: Vendime të çështjeve të ndryshme, kontrata, konkurse, përgjigje në Padi për Gjykatën, njoftime, përgjigje në kërkesa, ankesa, vërtetime, pëlqime si dhe shkresa tjera;
- ❖ Kemi përfaqësuar DKA-në, në Gjykatën Themelore Dega në Viti, në kërkesëpaditë të ushtruara nga personeli arsimor dhe palët;
- ❖ Për këtë periudhë kohore, për vitin 2022 kemi shpallur 4 konkurse publike, 2 konkurs për mësimdhënës dhe 2 konkurse për drejtor të shkollave. Janë pranuar 2 drejtor të shkollave dhe 38 mësimdhënës, duke përfshirë listën e pritjes;
- ❖ Me kohë kemi shpallur konkurse publike për kuadër arsimor për vendet e lira të punës dhe ndryshimet në listat e pagave, futjen në sistemin e pagesave i kemi bërë me kohë në fillim të ç'do muaji;
- ❖ Kemi bërë një planifikim të mirë, pasi që të gjithë punëtorët arsimor janë të pajisur me kontrata të punës dhe të gjithë të punësuarit në sektorin e arsimit janë të futur në sistemin e pagave;
- ❖ Gjatë punës ky sektor gjithmonë ka parasysh parimin e efikasitetit në punë, me rastin e shqyrtimit të kërkesave, ankesave dhe veprimeve tjera procedurale, duke respektuar afatet ligjore.

7. Sfidat e paraqitura

- Fillimisht Pandemia dhe mësimi në distancë;
- Rënia e numrit të nxënësve dhe sfidat me formulën e financimit;
- Shkolla e Pozheranit dhe zhvillimi i mësimin me pesë (5) ndërrime;
- Mungesa e Sallave sportive për të zhvilluar lëndën e Edukimit Fizik gjatë sezonës së Dimrit;
- Obligimet e Kontratës Kolektive dhe vendimet e përmbaruesve.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

- ☐ Shqyrtimi i 1 kërkesave për leje ndërtimore, 2 kërkesave për pëlqim urbanistik;
- ☐ Shqyrtimi i 13 kërkesave për Legalizim të Objekteve pa Leje;
- ☐ Shqyrtimi i 3 kërkesave për Informata urbanistike;
- ☐ Shqyrtimi i 6 kërkesave për Kushte urbanistike urbanistike;
- Mirëmbajtja e tabelave të rrugëve dhe sistemit të adresave,
- ☐ Është bërë regjistri i objekteve të kategorizuara për Leje Mjedisore Komunale;
- ☐ Viti 2022 nga Kryetari i Komunës është shpallur vit i ambientit;
- ☐ Shënimi i datave me rendësi mjedisore siç është “Dita e Tokës” më 22 Prilli dhe 5 Qershori apo “Dita e Mjedisit”;
- ☐ Jemi në përfundim të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal;
- ☐ Jemi në proces të hartimit të Planit të Veprimit Lokal në Biodiversitet;

□ Eliminimin i 6 deponive të mëdha ilegale nëpër fshatrat, Në komunën tonë në sistem të menaxhimit të mbeturinave nga ndërmarrja “Ekohigjena” janë të përfshira qyteti dhe 19 fshatra mbi 2000 klient të faturuar.

□ Problem në vete janë fshatrat të cilat nuk janë nën sistemin e menaxhimit të cilat grumbullojnë e mbeturinave e bëjnë në deponi të egra dhe vend e pa vend, të cilat paraqesin rrezik permanent të ndotjes mjedisore. Këto 6 muajt e fundit së bashku me Drejtorin e Inspektionit dhe Shërbimeve Publike, janë larguar 5 deponi të mëdha të “egra” të krijuara në fshatrat Pozheran, Remnik, Beguncë, Smirë, Kabash si dhe në qytetin e Vitisë. Gjithashtu bashkë me Drejtorinë e Arsimit, Këshillat e fshatrave dhe shkollat fillore e të mesme nëpër të gjitha lokalitetet e Komunës së Vitisë janë marrë aksione pastrimi nëpër rrugët dhe lagjet e këtyre vendbanimeve janë mbjell bimë dekorative duke e zgjeru fondin e gjelbërit në zonën urbane dhe në zonat rurale; Dhe detyra e përgjegjësi të tjera që bien në kompetencat e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Ambientit.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Punët dhe aktivitetet e kryera në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për periudhën Janar – Qershor 2022 janë zhvilluar në bazë të programit të punës dhe kërkesave të parashtruara nga qytetarët dhe fermerët në lëmin e prodhimit të bujqësore.

Në këtë periudhë raportuese, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka kryer të gjitha procedurat për fermerët që kanë të bëjnë me: plotësimin e aplikacioneve, dhënien e këshillave dhe dorëzimin e tyre në MBPZHR, në mënyrë që këta fermer të jenë përfitues të mundshëm të subvencioneve, ku prej viteve të tjera mënyra e aplikimit ka qenë ndryshe për arsye se nuk është kërkuar fleta poseduese e tokës por vetëm me një Deklaratë nën Betim nga ana e Noterit, fermeri ka mundur të bëjë aplikimin për sipërfaqet e zotuar nën betim. Duhet cekur se afati kohor i aplikimit ka qenë i shkurtër por falë organizimit dhe angazhimit të zyrtarëve të bujqësisë është kryer me sukses dhe asnjë fermerë nuk ka ngelur pa aplikuar.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, gjatë periudhës Janar-Qershor 2022 ka kryer këto aktivitete të punës, gjithmonë bazuar në planin vjetor të punës të hartuar për vitin kalendarik Janar – Dhjetor 2022.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punë:

- Hartimi i planit vjetor të punës për vitin kalendarik 2022;
- Dërgimi në zyrën e Prokurimit projekt planin për projektet të cilat do të implementohen nga Drejtoria e Bujqësisë;
- Planet e punës mujore;
- Planet e punës gjashtëmujore;
- Raportet e mujore të punës;
- Punët rutine të kryera;
- Seminare dhe takime të ndryshme;
- Vizita në teren për vlerësim të dëmeve, regjistrime, evidenca, statistika, këshilla etj.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, aktivitetet e saja i kryen përmes Sektorëve:

1.1 Sektori për Bujqësi, Blegtori dhe Zhvillimi Rural

- Gjatë këtij viti janë realizuar thirrjet të cilat i ka shpallur MBPZHR, fermerët e blegtorisë për cilësi të qumështit, fermerët e të gjitha lëmive të bujqësisë për subvencione- pagesa direkt;

- Po ashtu kemi bërë vizita të shumta në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma, (është bërë rifreskimi i të dhënave mbi gjendjen në përgjithësi të të gjithë sektorëve të bujqësisë me të dhëna te reja;
- Hartimi i planit të mbjelljeve pranverore për vitin 2022;
- Kontrollimi dhe vizita në ferma blegtorale gjithsej 10 vizita Kemi vizituar fermerët kultivues të perimeve në serra, kultivuesit e pemëve të imëta, me qëllim që për së afërmi ti shohim kultivuesit tanë lidhur me kulturat që ata i kultivojnë, problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë kësaj periudhe;
- Dalje në teren për vlerësim të dëmeve sipas kërkesave të fermerëve;
- Organizimin e trajnimeve për fermerë;
- Është bërë thirrja për aplikimi për ngritjen e pemishteve me bimë drufrutore- Arra, por në mungesë të interesimit për aplikim nga ana e fermerëve ky aktivitet ka dështuar;
- Është iniciuar procedura për furnizim me farë të misrit, por për shkak të ankesave në Organin;
- Shqyrtues të Prokurimit Publik nga ana e kompanive dhe mungesa e bordit të OSHP-së ky projekt ka dështuar për shkak të vonesave;
- Kanë përfituar 50 fermer foli të zezë polietileni;
- Janë shpërndarë 90 koshere me bletë për 18 fermerë me nga 5 koshere me bletë (projekt i bartura nga viti i kaluar);
- Janë vendosur 100 serra me sipërfaqe prej 50m², 40 serra nga Drejtoria e Bujqësisë dhe 60 Drejtoria e Bujqësisë me organizatën IKC.(projekte të bartura nga viti i kaluar);
- Është iniciuar proceduara për furnizim me 50 motokultivator për fermer;
- Janë bërë përgatitjet e nevojshme për fushatën e korrije shirjes;
- Vizitë,, mullinjve për verifikimin e masave të marra për kryerjen e 3 DDD. Janë vizituar të gjitha depot e mullinjve (2 mullinj).

Thirrjet - Aplikimi për fermerë nga ana e MBPZHR

Nga data: 21.01-11.02.2022-

Thirrja për aplikim për fermerët e lëmisë së blegtorisë për cilësi të qumështit Gjithsej kanë aplikuar 26 fermerë.

Nga data: 26.04-27.05.2022

Thirrja për aplikim për subvencione – pagesa direkt për fermerët e lëmisë së bujqësisë Gjithsej kanë aplikuar 1045 fermerë, prej tyre 38 femra dhe 1007 meshkuj.

- 1. Për Subvencione të Grurit kanë aplikuar: 650 Fermer.
- 2. Për Subvencione të Misrit kanë aplikuar: 586 Fermer.
- 3.Për Subvencione të Thekrës kanë aplikuar: 2 Fermer.
- 4Për Subvencione të Tërshërës kanë aplikuar: 2 Fermer
- 5.Për Subvencione të Perimeve kanë aplikuar: 255 Fermer.
- 6.Për Subvencione të Perimeve në serra : 9 Fermer.
- 7.Për Subvencione të Pemëve dru frutore kanë aplikuar: 114 Fermer.
- 8.Për Subvencione të Pemëve të imëta kanë aplikuar: 6 Fermer
- 9.Për Subvencione të Bletëve kanë aplikuar: 72 Fermer.
- 10.Për Subvencione të Deleve kanë aplikuar: 52 Fermer.

- 11.Për Subvencione të Dhive kanë aplikuar: 10 Fermer.
- 12.Për Subvencione të Lopëve qumështore kanë aplikuar: 145 Fermer.
- 13.Për Subvencione të Derrave kanë aplikuar: 3 Fermer.
- 14.Për Subvencione të Pulave vojse kanë aplikuar: 3 Fermer.

Trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Bujqësisë

Që nga fillimi i vitit janë organizuar trajnime për fermerë nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë në bashkëpunim me Organizatat të cilat veprojnë në Viti

Gjatë muajit Janar është mbajtur trajnimi në lëminë e blegtorisë për **Cilësi të Qumështit –DB dhe IADK**

Gjatë muajit Mars është organizuar trajnimi dy ditorë për fermerë- tema **Marketingu-DB-IADK**
Në këtë muaj po ashtu është mbajtur trajnimi në lëminë e blegtorisë për **Cilësi të Qumështit –DB dhe IADK**

Organizimi i trajnimit me zyrtarët Departamentit të Këshillimoreve për fermerët e Komunës së Vitisë lidhur me temën: **Mbajtja e shënimeve në fermë**

Trajnim për **Sigurimin Bujqësor** për fermerët kultivues të kulturave bujqësore

Trajnim lidhur me **Imputet Ekologjike – Prodhimtaria Organike** organizuar nga Pepek- Caritasi Zvicerran, pjesëmarrës fermerët e perimk-kulturës dhe të pemëtarisë

Trajnim me fermerët kultivues të perimeve në serrë, fushë të hapur si dhe përpunuesit e komunës së Vitisë dhe Regjionit. Organizuar ng Caritasi Zvicerran – Pepek dhe Drejtoria e Bujqësisë

Tema- **Zingjiri i Vlerës dhe Financimi i Bujqësisë**

Trajnim dy ditorë për **Menaxhim të Kontratës** përmes prokurimit, ku pjesëmarrës ishim zyrtarë nga Komuna e Vitisë dhe dy zyrtarë nga Drejtoria e Bujqësisë

Grandet dhe Subvencionet nga Komuna :

Komuna e Vitisë – Drejtoria e Bujqësisë

1.Gjatë muajit Prill – vendosja e serrave me sipërfaqe prej 50m², për 40 përfitues. Ky projekt ka qenë i vitit të kaluar mirëpo për shkak të kushteve atmosferike nuk ka mundur të implementohet

Vlera e projektit ishte 25.400 Euro.

2.Në muajin Maj- shpërndarja e folisë polietileni e zezë për 50 përfituesit me nga 0.50/ha të cilët janë kultivues të shalqirit, gjithsej për 25/ha

Vlera e projektit: 9,000 Euro

3.Në muajin Qershor –shpërndarja e 90 koshereve me bletë për 18 bletarë me nga 5 koshere.

1. **Vlera e projektit: 8,460 Euro**

Totali i investimeve në Bujqësi nga Komuna e Vitisë në gjashtë mujorin e parë është: **42,860 Euro**

1.2 Sektori për Pylltari

- Përgatitja e planit të prerjes;
- Hartimi i planit operativ për mbrojtjen e pyjeve;
- Shqyrtimi i kërkesave për prerje në pyjet private;
- Takime të rregullta me stafin e pylltarisë, realizimi i detyrave të punës;
- Nga pyjet publike janë transportuar nga tenderi, dru zjarri: 685m³, dhe janë lëshuar 64 fletëpërcjellje;

- Nga pyjet private janë parashtruar 33 kërkesa , 10 janë realizuar dhe 23 janë në pritje për tu realizuar gjatë muajve në vijim;
- Janë transportuar dru zjarri 83m³, dhe janë lëshuar 23 fletëpërcjellje;
- Të hyrat nga taksat për pyje private janë realizuar **983.87Euro;**
- Janë konfiskuar gjithsej 8 automjete ku masa drusore është 21m³;
- Të hyrat nga automjetet e konfiskuara janë **1,250 Euro;**
- Patrullime të përbashkëta me policinë kanë qenë 10, të realizuara me sukses, ndërsa patrullime brenda autoritetit komunal në Viti kanë qenë mbi 50 patrullime rutinore.
- Janë mbyllur me eskalatorë 3 rrugë në pyje që kanë ndikuar në zvogëlimin e dëmtimit të pyjeve
- Në bashkëpunim me Agjensionin Pyjor të Kosovë janë planifikuar **15/ha** pyllëzim dhe ripyllëzim.

1.3 Të hyrat nga taksat komunale që i përkasin Drejtorisë së Bujqësisë

Duke u bazuar në të hyrat që krijohen nga grumbullimi i taksave komunale nga domeni i bujqësisë paraqitet kjo gjendje ;

Të hyrat nga :

- Ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore : **9,238.75 €**, dhe

Gjithsej të hyra : 9,238.75 €,

1.11 Shqyrtimi i kërkesave të drejtuara përmes arkivit të komunës

Gjatë këtij gjashtëmujori nga arkivi i komunës kanë arritur gjithsej 76 kërkesa, prej tyre :

Të bartura nga viti paraprak	Të pranuar Janar-Qershor	Gjithsej të pranuar	Të miratuara	Në proces	Gjithsej të shqyrtuara
/	76	76	41	35	76

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, është e rregulluar me një sistemim dhe në bazë të organogramit të brendshëm dhe përshkrimit të detyrave dhe obligimeve të punës të secilit zyrtar, ku aktualisht në këtë drejtori punojnë 9 zyrtar të cilët janë me kualifikimet e nevojshme për ti plotësuar nevojat e punës dhe të funksionimit të secilit sektor në Drejtori.

Në kuadër të DKPGJ-së ekzistojnë tre sektorë:

- Sektori i Kadastrit
- Sektori i Pronës, dhe
- Sektori i Gjeodezisë

4.1 Sektori i Kadastrit

Puna në Sektorin e Kadastrit është e bazuar në dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë këtë sektor, i cili është përgjegjës për kujdesen dhe mirëmbajtje e të gjitha regjistrave kadaslral, ku përfshihet e gjithë paluajtshmeria komunale, si dhe regjistri i paluajtshmerive, hipotekave, servituteve digjitale dhe manual, si shërbim kryesor për qytetarët si shërbimi me lëshimin e fletave poseduese, çertifikatave personale dhe social.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime kadastrale:

Muaji	Fleta poseduese +K.P	Çertifikata për N. Sociale	Hipoteka	Transaksione Pronësore
Janar - Qershor	1820	900	48	432 lëndë

Tabela nr.1 Shërbimet kadastrale për periudhën Janar – Qershor 2022

4.2 Sektori i Pronës

Sektori i pronës ka përgatitë 5 propozim vendime për bordin e drejtoreve dhe Kuvendin komunal, ne lidhje me natyrën e punëve ne Drejtori në vazhdimësi ka bërë interpretimin e normave ligjore që janë në fuqi, ka kryer punë administrative në Drejtori: përpilimin e aktvendimeve, urdhëresave dhe akteve tjera, ka lëshuar vërtetime për pronat qe komuna nuk ka interes ti blejë ato.

I ka pranuar kërkesat e drejtura Drejtorisë, i ka shqyrtuar ato dhe ju është përgjigjur me shkrim. Ka zhvilluar procedurat për ekspropoim të tokave në pronësi private për interesa të përgjithshme publike.

4.3 Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë për gjatë periudhës raportuese ka kryer këto shërbime për palët dhe Komunën si ka : Mirëmbajt kadastrën digjital në sistemin kosovaref01 ka përcjell vektorizimin e raster planeve, ka përgatitë dhe mbikëqyrë të dhënat për kompanitë dhe gjeodetët e licencuar, ka përgatitë raportet ditore për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka pranuar lëndët e kryera nga kompanitë dhe gjeodetët e licencuar dhe të njëjtat i azhurnon në sistemin zyrtar (SIKTK-T dhe SIKTK-G), ka bërë azhurnimin e ndarjeve fizike në librat e regjistrimeve të nëndarjeve kadastrale, ka bërë Hartimin e kopjeve të Planit, Kontroll të vazhdueshme kualitetit të të dhënave grafike kadastrale dhe atyre tekstuale, projektim të rrjeteve referente, të rendit të tretë të shtruar me GPS, Identifikim i parcelave në zyrë. Futja e të dhënave grafike në datamodelin zyrtar (SIKTK-G). Konsulta dhe këshilla profesionale në lëminë e Gjeodezisë dhe Kadastrës, për palët e interesuara në kuadër të shërbimeve kadastrale

Muaji	Legalizime	Ndarje/azhurnime	Bashkim i parcelave	Ndërrim kulture
Janar -Qershor	35	113 ndarje	24	1

Tabela Nr.3 Shërbimet në sektorin e Gjeodezisë Janar-Qershor 2022

1. Të hyrat financiare

Në Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi planifikimi i të hyrave buxhetore për vitin 2022 duke përfshirë të gjithë sektorët ka qënë 57,400.00 €, kurse realizimi i të hyrave deri në periudhën Janar – Qershor 2022 është 40,972.00 €.

5. Sfidat

5.1 Pengesat të cilat i ka përcjell këta Sektorë janë:

- Mungesa e shënimeve prej vitit 1982 – 1999.

- Lidhjet e dobëta digjitale në bazën e të dhënave dhe shpeshherë ndërprerja e tyre kohë pas kohe me Agjencinë Kadastral të Republikës së Kosovës.
- Mungesa e shënimeve gjeodezike nga viti 1985 – 1999.
- Mungesa e planeve/skicave për zonat kadastrale. të cilat janë pjesë të komasacionit.

5.2 Propozim masat të cilat duhet të merren për efikasitet janë:

- Insistimi i faktorëve institucional, vendor dhe ndërkombëtar tek Institucionet e Serbisë për kthimin e shënimeve kadastrale dhe gjeodezike, respektivisht planeve gjeodezike.
- Insistimi i institucioneve vendore dhe i mekanizmave ndërkombëtar tek institucionet e Serbisë, për kthimin e dokumentacionit kadastral, të konfiskuar (gjatë luftës).
- Përpjekjet për përmirësimin e lidhjeve digjitale në bazën e të dhënave me Agjensionin Kadastral të Republikës së Kosovës.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Raporti i punës i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport bazohet në raportet e udhëheqësve të sektorëve të Kulturës, Rinisë, Sportit, Bibliotekës, Shtëpisë së Kulturës si dhe Arkivit Historik. Raporti paraqet në vija të trasha shtyllat kryesore të aktiviteteve të Drejtorisë:

I. Investimet KAPITALE

1. Vazhdimi i punimeve në Palestrën e Sportit në Drobesh;
2. Vazhdimi i punëve në përfundimin e stadiumit të futbollit “Ibrahim Kurteshi “ në Pozheran;
3. Ndërtimi i fushave sportive në disa lokalitete në Viti;
4. Konkursi publik për ndarje të Subvencioneve;
5. Rritja e subvencioneve nga 38.000 euro në 50.000 euro;
6. Procesi i ndarjes së subvencioneve është në fazën përfundimtare.

II. Sektori i Kulturës

1. Përgatitja e planit vjetor të aktiviteteve për vitin 2022;
2. Aplikimin me dy projekte në Ministri: Projekti për pasurimin e muzeut dhe projekti për Bibliotekën komunale;
3. Bashkë-organizimin e 17 shkurtit – Ditës së pavarësisë së Kosovës
4. Ekspozita e pavarësisë;
5. Bashkë-organizimin e manifestimit tradicional “Flakadani i Karadakut 2022” me Ekspozitë, Gara të recituesve, Ora letrare, Festivali i Ansambleve dhe ShKA;
6. Bashkë-organizimin e 5 majit-Ditës së Dëshmorëve;
7. Bashkë-organizimin e 14 qershorit – Ditën e çlirimit të Vitisë;
8. Sukseset e QK “Anamorava “ dhe AKV “Kemajl Azizi” në Festalet kombëtare dhe ndërkombëtare nga mbështetja e fuqishme e DKRS-së;
9. Mbështetja e festivalit ndërkombëtar “N’KARADAK KRISIN TUPANAT”;
10. Bashkë-organizimi i 3 majit – Ditës së Kerim Lewtonit (Mediat e lira);
11. Organizimi i kampit të trashëgimisë kulturore në Letnicë.

Sektori i Sportit

1. Përgatitjen e planit të punës për vitin 2022;

2. Mirëmbajtjen me të dhëna të faqes së internetit në Facebook;
3. Organizimin e Lojërave në Basketboll mes Klubit Vitia dhe KFOR-it;
4. Organizimin e garave sportive në Futboll të vogël, takewendo, Shah në manifestimin tradicional "Flakadani i Karadakut" 2022;
5. Mbështetja e 5 turneve të futbollit të vogël të organizuara në Komunën e Vitisë;
6. Organizimi i turneve dhe aktiviteteve sportive.

III. Sektori për RINI

1. Memorandume bashkëpunimi me disa organizata si: USAID, Caritas Kosova, YARL, CEB, Social HUB-Gjilan;
2. Aftësim profesional (Kurse) për të rinjtë;
3. Tryeza "Rinia dhe Shteti";
4. Mbështetja e aktiviteteve rinore;
5. Implementimi i projektit UP To Youth ku të rinjtë kanë pasur mundësinë e trajnimeve të ndryshme, punës praktike etj;
6. Organizimin e manifestimit të 01 Qershorit – Ditës ndërkombëtare për fëmijë.

IV. Sektori i Bibliotekës

1. Donacione 73 tituj me 631 libra;
2. Shërbimet të lexuesve për Fëmijë;
3. Shërbime të lexuesve për të rritur;
4. Përpunimi i 732 titujve me 1302 libra.

V. Shtëpia e Kulturës

1. 119– shërbime institucionale, OJQ-ve dhe personave fizik.

VI. Sektori i Arkivit Historik

1. 69 - Kërkesa për shërbime në Arkivin Historik.
2. 47 – Kërkesa të realizuara.
3. 11– Kërkesa të pa realizuara.
4. 11- në proces.

Viti, Korrik 2022

**Kryetari i Komunës
Sokol HALITI**

